


RRJETËZIMI I PËRGGJIGJËS SË SHOQËRISË CIVILE NDAJ KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR



WESTERN BALKANS
ORGANIZED CRIME
RADAR



BCSP

Shkurt 2021

RRJETËZIMI I PËRGGJIGJËS SË SHOQËRISË CIVILE NDAJ KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Shkurt 2021

Botues:

Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë (BCSP)

Redaktor:

Bojan Elek

Autorë:

Plator Avdiu, Shpat Balaj, Dina Bajramspahić, Imer Dulaš, Dragana Janićijević, Miloš Jovanović, Magdalena Lembovska, Benjamin Plevljak, Redion Qirjazi, Romario Shehu

Përkthimi në shqip:

Lexica

Dizajni dhe faqosja:

Srdjan Iliq



Kingdom of the Netherlands

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy
Belgrade

Mendimi i shprehur në këtë botim nuk përfaqëson mendimin e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd ose të Fondit Ballkanik për Demokraci, as të Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë, të paktën në nivel deklarativ, në krye të agjendave të qeverive të Ballkanit Perëndimor për gati një dekadë tani. Ky zotim shpesh ishte vetëm deklarativ, i sjellë nga aktorë të jashtëm, ku i tillë është BE përmes procesit të pranimit që përfshin gjashtëshen e BP dhe vë theksin në nevojën për të trajtuar krimin e organizuar në mënyrë më efektive. Ndërsa perspektiva e zgjerimit konsiderohej ende e besueshme dhe e gjallë, qeveritë kishin stimuj për të investuar përpjekje në zhbërjen e rrjetit të organizuar kriminal që tradicionalisht ka qenë i organizuar më mirë sesa vetë qeveritë. Me fillimin e të ashtuquajturës lodhje të zgjerimit dhe pa ndonjë të ardhme të sigurt evropiane për gjashtëshen e BP, këta stimuj u humbën. Kjo, e shoqëruar me mungesën e nxitjes së mirëfilltë, organike për të trajtuar krimin e organizuar brenda vendeve, çoi në rënien në dëshpërim të shpresave të qytetarëve për shoqëri pa krim.

Ky raport hulumtimi ka për qëllim të hetojë një pjesë të problemit të përshkruar më sipër, respektivisht të përcaktojë pse qeveritë e BP nuk po i përmbushin zotimet për të trajtuar krimin e organizuar. Për ta bërë këtë, një pyetje që duhet adresuar së pari është se si dikush madje mund të vlerësojë efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar në gjashtëshen e BP. Me sa duket, ndërsa ka kuptim të përgjithshëm që rezultatet lënë për të dëshiruar, ekziston një boshllëk si në të dhënat statistikore administrative ashtu edhe në bazë të sondazheve të disponueshme për publikun, gjë që e bën të vështirë të përcaktohet se sa efektive janë përgjigjet e shtetit kundër krimit të organizuar. Kjo lë hapësirë për narrative konkurruese në lidhje me rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar. Kjo është arsyeja pse është e mundur të kemi, në të njëjtën kohë, një qeveri të BP që pretendon se po udhëheq një luftë shumë të suksesshme ndaj mafisë, dhe në të njëjtën kohë ka raporte të besueshme dhe ekspertë udhëheqës që pretendojnë se e njëjta qeveri është kriminalizuar thellësisht dhe lufta e përmendur ndaj mafisë nuk është veçse një marifet mediatik.

Sfida e parë e identifikuar në këtë raport është mungesa e të dhënave të besueshme mbi krimin e organizuar, që është pengesa e vetme më e madhe për të pasur debat publik të informuar me prova mbi këtë çështje. Edhe pse kjo është çështje tashmë e njohur, vlen të përmendet se shumica e vendeve në rajon nuk kanë sisteme statistikore të afta për të mbledhur dhe monitoruar të dhënat për krimin e organizuar. Nëse ekzistojnë këto sisteme, të dhënat ndryshojnë shumë midis llojeve të ndryshme të krimit ose nuk ndahen për të lejuar analiza domethënëse. Një detyrë veçanërisht e vështirë është të përcjellët një rast përmes sistemit të drejtësisë penale sepse nuk ka identifikues unikë që do ta lejonin këtë. Për më tepër, të dhënat zakonisht nuk janë të disponueshme në të gjitha institucionet dhe, edhe pas marrjes së tyre përmes kërkesave të lirisë së informacionit, pak konkluzione mund të nxirren për shkak të sistemeve të menaxhimit të rasteve që përdorin indikatorë të ndryshëm që nuk lejojnë krahasim domethënës.

Gjetja e dytë kryesore është se, megjithëse parakushtet ligjore dhe strategjike kryesisht ekzistojnë në gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor, është zbatimi ai që lë shumë për të dëshiruar. Agjencitë e zbatimit të ligjit shpesh janë me kapacitete të pamjaftueshme, atyre u mungon koordinimi dhe burimet e duhura për të qenë në gjendje të përmbushin me sukses mandatet e tyre. Për më tepër, është kuptim i përgjithshëm i të gjithë bashkëbiseduesve të intervistuar në procesin e hartimit të këtij raporti se bashkëpunimi i mjaftueshëm i agjencive të zbatimit të ligjit është faktori më i rëndësishëm për trajtimin e krimit të organizuar. Megjithëse ekzistojnë marrëveshje bilaterale dhe ekzistojnë mori

forumesh rajonale dhe ndërkombëtare për bashkëpunimin e agjencive të zbatimit të ligjit, ekzistojnë pengesa që parandalojnë bashkëpunimin më efektiv dhe përgjigjen më të koordinuar.

Së fundmi, politika luan rol të madh qoftë përmes ndikimit politik mbi agjencitë e zbatimit të ligjit, mungesës së vullnetit politik për të luftuar krimin e organizuar ose vullnetit politik për të mos e luftuar atë, ku duket se politika është pengesa kryesore për të pasur përgjigje më të mira të shtetit ndaj krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Strategjia e Besueshme e Zgjerimit e BE-së nga viti 2018 theksonte se “vendet tregojnë elemente të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës.” Prandaj janë liderët politikë që janë njëkohësisht zgjidhësit kryesorë të problemit dhe problemi kryesor që duhet të zgjidhet, prandaj u takon atyre që në fund të fundit të marrin përgjegjësinë për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për të luftuar kundër krimit të organizuar dhe për të rritur qëndrueshmërinë shoqërore ndaj dëmeve të tij.

Shqipëria	8
Përmbledhje ekzekutive	9
Hyrje	10
Analiza e kuadrove ligjore dhe strategjike	11
Kuadri strategjik	12
Profili i OShC-ve kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit	13
Burimet	13
Njohuria	14
Praktikat	15
Bashkëpunimi	16
Sfidat	16
Perspektiva e drejtësisë penale	17
Konkluzione	18
Rekomandime	19
Bibliografia	20

Bosnja dhe Hercegovina	22
Përmbledhje Ekyekutive	23
Hyrje	24
Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike	24
Burimet	25
Njohuria	26
Praktikat	27
Bashkëpunimi	28
Sfidat	28
Perspektiva e drejtësisë penale	29
Konkluzione	30
Rekomandime	31
Bibliografia	32

Kosova	33
Përmbledhje ekzekutive	34
Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike	35
Korniza kushtetuese dhe ligjore	35
Korniza strategjike	36
Burimet	37
Sfidat	37
Njohuria	38
Praktikat	39
Bashkëpunimi	40
Perspektiva e drejtësisë penale	41
Konkluzione	42
Rekomandime	43
Bibliografia	44


Mali i Zi	45
Hyrje	46
Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike	47
Burimet	48
Njohuria	49
Praktikat	49
Bashkëpunimi	51
Sfidat	52
Konkluzione	54
Rekomandime	55
Bibliografia	56

Maqedonia e Veriut	57
Përmbledhje ekzekutive	58
Hyrje	59
Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike	59
Burimet	60
Njohuria	62
Praktikat	62
Bashkëpunimi	63
Sfidat	64
Perspektiva e drejtësisë penale	65
Konkluzione	66
Rekomandime	67
Bibliografia	68

Serbia	69
Përmbledhje ekzekutive	70
Hyrje	71
Analiza e Kornizës Ligjore dhe Strategjike	71
Zbatimi praktik i normave ligjore	72
Burimet	73
Njohuria	74
Praktikat	74
Bashkëpunimi	75
Sfidat	76
Perspektiva e drejtësisë penale	77
Konkluzione	78
Rekomandime	78
Bibliografia	79

Shqipëria

Autorë: **Redion Qirjazi, Romario Shehu**



Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë përpjekjet aktuale dhe ndikimin e organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e projekteve kundër krimit të organizuar, të shqyrtojë sfidat dhe të identifikojë qasjet e suksesshme. Studimi gjithashtu kërkon të japë rekomandime për të forcuar më tej rolin e organizatave të shoqërisë civile që zbatojnë projekte kundër krimit të organizuar në Shqipëri.

Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në përpjekjet kundër krimit të organizuar pengohet nga një numër faktorësh të ndërlidhur. Organizatat e shoqërisë civile nuk janë të përqendruara në luftën kundër krimit të organizuar pasi ato tradicionalisht kanë parë rolin e tyre në përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga donatorë të huaj, të cilët nuk i kanë dhënë prioritet çështjes së luftës kundër krimit të organizuar.

Mungesa e ndërveprimit midis organizatave të shoqërisë civile dhe sistemit të drejtësisë penale e bën akoma më të vështirë që organizatat e shoqërisë civile të përfshihen në përpjekjet kundër krimit të organizuar. Ka vetëm disa organizata të shoqërisë civile që zbatojnë projekte kundër krimit të organizuar në Shqipëri (kryesisht mbështetje të viktimave dhe parandalim të krimit) dhe nuk ka asnjë rrjet të organizatave të shoqërisë civile kundër krimit të organizuar.

Raporti përfundon me rekomandime specifike se si të përmirësohet roli i organizatave të shoqërisë civile që zbatojnë projekte kundër krimit të organizuar në Shqipëri. Ekziston nevoja për të krijuar një rrjet të organizatave të shoqërisë civile kundër krimit të organizuar në mënyrë që të rritet bashkëpunimi i tyre, t'i jepet hov rolit të tyre në terren dhe të organizohen aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve sepse ato nuk kanë qenë në gjendje të përballen me natyrën evolucionare të krimit të organizuar në Shqipëri. Donatorët e huaj duhet t'i japin prioritet çështjes së luftës kundër krimit të organizuar, pasi që kjo është çështje thelbësore në vend.

Ekziston nevoja për të diversifikuar rolin e organizatave të shoqërisë civile në hulumtimin e krimit të organizuar në Shqipëri dhe në praktikat institucionale të përdorura për ta luftuar atë. Sistemi i drejtësisë penale duhet të jetë më i hapur dhe më bashkëpunues me organizatat e shoqërisë civile. Është thelbësore për autoritetet që zbatojnë ligjin të ofrojnë siguri për ata që zbatojnë aktivitete kundër krimit të organizuar. Shoqëria civile duhet të rrisë ndërgjegjësimin në fushën e krimit të organizuar dhe të ndërtojë një kundërnarrativë, sepse një përqindje e konsiderueshme e të rinjve nuk e perceptojnë atë si domosdoshmërisht të keq.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë përpjekjet aktuale dhe ndikimin e organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e projekteve kundër krimit të organizuar, të shqyrtojë sfidat e tyre dhe të identifikojë qasje të suksesshme. Më tej, ai kërkon të japë rekomandime për të forcuar, mbështetur dhe promovuar më tej organizatat e shoqërisë civile që zbatojnë projekte kundër krimit të organizuar në Shqipëri.

Studimi bazohet në metodën e hulumtimit cilësor duke përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Hulumtimi kishte tre faza, i) rishikim tryeze i literaturës së mëparshme dhe informacionit përkatës në lidhje me temën, ii) 10 intervista të strukturuar me përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe një fokus grup me profesionistë të drejtësisë penale (policia, prokuroria, gjykatat, burgu); intervistat dhe grupi i fokusit u administruan përmes një pyetësori gjysmë të strukturuar, dhe iii) një analizë e të gjitha të dhënave të mbledhura.

Ky hulumtim hedh dritë në disa gjetje. Së pari, ka pasur pak përqendrim në agjendën kundër krimit të organizuar në Shqipëri për dekadën e fundit apo më shumë, dhe shumë pak organizata të shoqërisë civile zbatojnë në mënyrë primare projekte kundër krimit të organizuar. Së dyti, qasjet aktuale të përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile kundër krimit të organizuar në Shqipëri janë mjaft një-dimensionale - respektivisht, shumica e punës së bërë në sektor ka të bëjë me mbështetjen e viktimave të krimit të organizuar. Së treti, mungesa e ndërveprimit midis organizatave të shoqërisë civile dhe sistemit të drejtësisë penale për të marrë informacion e bën akoma më të vështirë për organizatat e shoqërisë civile që të përfshihen në përpjekjet kundër krimit të organizuar.

Si përfundim, ka disa kufizime në këtë hulumtim dhe tentimet e tij për të analizuar përpjekjet aktuale dhe ndikimin e shoqërisë civile në zbatimin e projekteve kundër krimit të organizuar, dhe identifikimin e qasjeve të suksesshme. Ky studim është i pari që merret me rolin e shoqërisë civile në zbatimin e projekteve kundër krimit të organizuar në Shqipëri, kështu që fushëveprimi dhe thellësia e analizës së tij mund të mos paraqesin pamjen e plotë - prandaj, kontributi i tij më i madh është hapja e rrugës në këtë fushë, dhe më shumë hulumtime janë të nevojshme për të pasuruar kuptimin e kësaj teme.

Analiza e kuadrove ligjore dhe strategjike

Kuadri ligjor

Aktiviteti i organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) në Shqipëri rregullohet nga Ligji Nr. 8788/2001 (i ndryshuar në 2007 dhe 2013) "Për Organizatat Jofitimprurëse"¹ i cili përcakton rregullat për krijimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Kuadri ligjor siguron kufij të qartë për mbikëqyrjen e qeverisë mbi OShC-të, dhe OShC-të kanë të drejtë të apelojnë ndaj vendimeve administrative.

Për të mbështetur zhvillimin e OShC-ve dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional midis tyre dhe Qeverisë së Shqipërisë (QSh), janë miratuar dy ligje, i) Ligji Nr. 10093/2009, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)" dhe ii) Ligji Nr. 119/2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)".² Objektivi kryesor i AMShC është kanalizimi i fondeve nga qeveria dhe donatorët tek OShC-të, ndërsa KKShC synon të lehtësojë bashkëpunimin institucional midis QSh dhe OShC-ve.³

Raporti i Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile 2019⁴ vëren disa probleme në mjedisin ligjor të OShC-ve në Shqipëri. Së pari, proceset për regjistrimin e OShC-ve, ndryshimin e statuteve të tyre dhe çregjistrimin janë të centralizuara, burokratike, të gjata dhe të kushtueshme, veçanërisht për OShC-të jashtë Tiranës. Së dyti, Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, paraqet rrezik për ndërhyrjen e shtetit në veprimtaritë e OShC-ve. Së treti, Ligji për Vullnetarizmin duhet t'u mundësojë OShC-ve që të mbështeten te vullnetarët për të vepruar kur u mungon fondi. Së katërti, Ligji për Ndërmarrjet Shoqërore mbetet problematik sepse OShC-të me statusin e ndërmarrjeve shoqërore kanë aftësi të kufizuara për të krijuar të ardhura nga aktiviteti i tyre ekonomik. Së pesti, trajtimi fiskal i qeverisë ndaj OShC-ve është i ngjashëm me organet e tjera të tatueshme. Së fundmi, disa burime ligjore janë në dispozicion për OShC-të, veçanërisht ato me seli jashtë Tiranës.⁵

Nuk ka ndonjë rregullim ose raport specifik për nevojën e përfshirjes së OShC-ve në luftën kundër krimit të organizuar (KO). Pas një serie takimesh konsultative, një raport i vitit 2019⁶ vëren se, roli i OShC-ve në përpjekjet kundër KO në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe globalisht, duhet të jetë për të hulumtuar temën, për të rritur ndërgjegjësimin, për të monitoruar përgjigjet e qeverisë dhe për të mbajtur presionin mbi institucionet shtetërore.

1 Qendra e Botimeve Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Për Organizatat Jofitimprurëse. Marrë nga: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2001/28>

2 Bino dhe të tjerët, 2020. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

3 Qendra e Botimeve Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile (2019-23). Marrë nga: <https://qbz.gov.al/share/Gz6YWy0kSBOPHiQH8F8cog>

4 Azizaj dhe Shehu, 2020. Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2019, Uashington D.C.: Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

5 Po aty, f. 2-3.

6 Amerhauser, 2019. Si mundet shoqëria civile t'i kundërvihet krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor? Vështrime dhe rekomandime nga angazhimet e tryezës së rrumbullakët me aktorët e shoqërisë civile në të gjithë rajonin, Gjenevë: Nisma Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Këshilli i Ministrave të Shqipërisë miratoi Udhërrëfyesin⁷ për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (2019–2023), të rishikuar në korrik 2019, përmes një procesi të hapur dhe pjesëmarrës.⁸ Plani përfshin dyzet e dy veprime që qeveria duhet të ndërmarrë në mënyrë që të krijojë një mjedis mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Sidoqoftë, duke pasur parasysh zbatimin e dobët të Udhërrëfyesit 2015, që përfundoi me gati 80 përqind të veprimeve të planifikuara të raportuara si të pazbatuara, OShC-të kanë pritje të ulëta⁹ për realizimin e Udhërrëfyesit të rishikuar.

Një Qendër Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (QKBShC) u nis¹⁰ në vitin 2019, si një platformë për shoqërinë civile në nivel kombëtar për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve, dialogun e politikave dhe përpjekjet e avokimit për një mjedis mundësues në sektor.

Në përgjithësi, sektori i shoqërisë civile ka bërë progres të dukshëm në Shqipëri. Sipas një sondazhi të vitit 2019, OShC-të perceptohen si mekanizmat e dytë më të efektshëm të llogaridhënies vertikale në vend.¹¹ Sidoqoftë, ekziston një tendencë e tanishme drejt tkurrjes së hapësirës së shoqërisë civile në Shqipëri, e cila parandalon OShC-të të shprehin shqetësimet e komuniteteve të ndryshme dhe të kryejnë rolin e tyre vëzhgues në mënyrë efektive.¹² Ndër treguesit për këtë tendencë janë pengesat e OShC-ve në ushtrimin e plotë të funksioneve të tyre për kanalizimin e shqetësimeve të qytetarëve në proceset e politikave përmes pjesëmarrjes kuptimplotë dhe mekanizmave të mirëfilltë të konsultimit dhe fushatave të shpifjeve dhe imazhit negativ të OShC-ve në sferën publike, duke kërkuar të diskreditojnë dhe delegjitimojnë rolin dhe punën e shoqërisë civile në vend.¹³

7 Qendra e Botimeve Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile (2019-23). Marrë nga: <https://qbz.gov.al/share/Gz6YWY0kSBOPHiQH8F8cog>

8 Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri. Udhërrëfyesi drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (2019-23) Marrë nga: <https://resourcecentre.al/sq/2019/07/26/udherrefyesi-per-hartimin-e-politikes-dhe-masave-per-nje-mjedis-mundesues-per-zhvillimin-e-shoqerise-civile-2019-2023/>

9 Azizaj dhe Shehu, 2020. Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2019, Uashington D.C.: Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

10 Azizaj dhe Shehu, 2020 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatës së Shoqërisë Civile 2019, Uashington DC: Shtetet e Bashkuara

11 Sondazhi i Opinionit “Besimi në Qeverisje”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim: 2020. Në dispozicion në: <https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2019/>

12 Bino dhe të tjerët, 2020. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrje në Shqipëri, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

13 Po aty, f. 21-22.

Profili i OShC-ve kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit

Ekziston një numër i vogël i OShC-ve që zbatojnë projekte kundër KO, dhe shumica e atyre që janë në shënjestër të këtij studimi argumentuan se ata nuk janë të përqendruar kryesisht në KO, por zbatojnë aktivitete që merren indirekt me disa nga çështjet e KO. Pothuajse gjysma e OShC-ve që zbatojnë aktivitete kundër KO janë përqendruar në mbështetjen e viktimave të trafikimit njerëzor duke synuar kryesisht gra, të rinj dhe fëmijë. Fushat kryesore të krimit në të cilat janë përqendruar OShC-të përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore, prostitucionin dhe shfrytëzimin e të miturve. Ndërsa ka pasur një progres të konsiderueshëm në sigurimin e mbështetjes së viktimave, këto përpjekje janë përqendruar te gratë - si viktimat të shfrytëzimit - por kanë lënë pas dore burrat - si kryes të shfrytëzimit. Për më tepër, fushat kryesore sfiduese të krimit në Shqipëri siç janë rrjeti midis politikës, biznesit dhe KO, pastrimi i parave dhe tregtia e paligjshme, mbeten jashtë fokusit të punës së OShC-ve.

Motivet e OShC-ve për të punuar në aktivitete të tilla sepse KO rrezikon të ardhmen e vendit sillen rreth adresimit të KO e deri te mbrojtja e interesit publik, mbrojtja e të drejtave të njeriut, edukimi i brezave të ardhshëm dhe arritja e mirëqenies sociale.

Shumica e të anketuarve besojnë se sektori i shoqërisë civile ka një rol të rëndësishëm në përpjekjet kundër KO; megjithatë, sektori aktualisht është duke mos funksionuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, mbështetjes financiare në një agjendë të jashtme të drejtuar nga donatorët dhe për shkak të mjedisit të pasigurt që paraqet KO. Të anketuarit besojnë se OShC-të mund të bëjnë shumë më tepër në këtë temë, veçanërisht duke rritur ndërgjegjësimin¹⁴ dhe duke përmbytur rolin e vëzhguesit, siç argumentoi një i anketuar “shoqëria civile shqiptare nuk po e përmbytur rolin e saj si vëzhgues duke monitoruar, ushtruar presion mbi institucionet dhe informuar qytetarët, gjëra të cilat janë thelbësore për demokracinë”.¹⁵

Burimet

Qëndrueshmëria financiare është një sfidë thelbësore përkundër përvojës, vendndodhjes ose madhësisë së OShC-ve. Shumica dërrmuese e OShC-ve nuk kanë fond rezervë në organizatën e tyre,¹⁶ dhe ka mungesë të diversitetit në burimet e financimit. Shumë nga OShC-të më të mëdha në vend vazhdojnë të mbështeten kryesisht në grante nga donatorë ndërkombëtarë, me pjesën më të madhe të fondeve që vijnë nga Bashkimi Evropian (BE).¹⁷ Financimi shtetëror është në dispozicion për OShC-të por ka mbetur i ulët për vite me radhë. Për më tepër, financimi i shtetit është i kufizuar dhe shpesh vjen

14 Intervista Nr. (5), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (20 gusht 2020).

15 Intervista Nr. (6), me përfaqësuesin e OShC-së në Vlorë (26 gusht 2020).

16 Partnerët Shqipëri, 2019. Hartëzimi dhe Vlerësimi i Rrjeteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri, Tiranë: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

17 Azizaj dhe Shehu, 2020. Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2019, Uashington D.C.: Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

me kushtëzime,¹⁸ goftë në formën e mbulimit të favorshëm për institucionet shtetërore ose të praktikave korruptive që ndërtojnë marrëdhënie klienteliste midis shtetit dhe OShC-ve.

Në një mjedis të tillë, OShC-të nganjëherë preferojnë të jenë vetëm në ndërmarrjen e iniciativave për të mbajtur veten financiarisht,¹⁹ dhe nganjëherë aplikojnë për fonde edhe në fushat ku ato nuk kanë ekspertizë specifike të nevojshme për zbatimin e projektit.²⁰ Kështu, bashkëpunimi midis OShC-ve bëhet jashtëzakonisht i vështirë në një mjedis ku burimet financiare janë të pakta dhe secila organizatë përpiqet të mbijetojë.²¹

Pamundësia për të krijuar organizata të strukturuar mirë dhe për të ndërtuar ekspertizë ka ndikuar negativisht në angazhimin e OShC-ve në iniciativa që kanë të bëjnë me veprime kundër KO. Mundësitë e kufizuara të financimit ndikuan në punën e OShC-ve në të gjitha nivelet dhe kanë çuar në një agjendë të drejtuar nga donatorët në vend të një agjende që është më e akorduar për t'iu përgjigjur nevojave lokale. Përkundër një roli të rritur kohët e fundit kundër KO të donatorëve të jashtëm në Shqipëri, disa të anketuar përshkruan mungesën e interesit të donatorëve si arsye kryesore pse kontributi i OShC-ve është kaq i dobët në përpjekjet kundër KO.

Njohuria

Infrastruktura e njohurive që mbështetin sektorin e OShC-ve është përmirësuar pak gjatë viteve të mëparshme pasi nën-grantet e reja dhe programet e asistencës teknike kanë ofruar mundësi për OShC-të shqiptare për të zhvilluar burimet dhe kapacitetet e tyre.²² Megjithatë trajnime të tilla rrallë kanë përfshirë temat kundër KO, pikëpamja e përgjithshme e të anketuarve është se ata mund të kontribuojnë indirekt në parandalimin e krimit duke organizuar fushata ndërgjegjësimi për të rinjtë dhe duke mbështetur komunitetet në parandalimin e atyre që rrezikojnë të kthehen ndaj krimit.

Siç tregohet nga të anketuarit e këtij studimi, përveç mediave dhe OShC-ve për mbështetjen e viktimave, të cilët përshkruhen gjatë intervistave si të informuar mirë në lidhje me KO, OShC-të e tjera perceptojnë se kanë pak njohuri në këtë fushë. OShC-të e angazhuara në mbështetjen e viktimave dhe sigurimin e shërbimeve theksuan se rregulloret e sferës së tyre të punës evoluojnë vazhdimisht dhe ato duhet të trajnojnë herë pas here personelin e tyre për rregulloret e ndryshuara dhe të rifreskojnë njohuritë e tyre.²³ Për këtë, OShC-të organizojnë trajnime për personelin e tyre ose marrin pjesë në trajnime të organizuara nga aktorë të tjerë, gjë që ka kufizimet e veta sepse informacioni i marrë është bazik, punëtoritë rajonale nuk pasqyrojnë ndryshimet në vend dhe njohuritë e rritura nuk çojnë domosdo në përparim në karrierë. Vlen të përmendet se OShC-të që janë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare ose rajonale janë në avantazh sepse ndarja e njohurive dhe ndërtimi i kapaciteteve është pjesë e objektivave të rrjeteve të tyre.

18 Intervista Nr. (7), me një përfaqësues të një grupi jozyrtar në Kamëz (27 Gusht 2020).

19 Intervista Nr. (10), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (8 Shtator 2020).

20 Intervista Nr. (5), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (20 gusht 2020).

21 Intervista Nr. (5), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (20 gusht 2020).

22 Azizaj dhe Shehu, 2020 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatës së Shoqërisë Civile 2019, Uashington DC: Shtetet e Bashkuara

23 Intervista Nr. (5), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (20 gusht 2020).

Ka pak projekte të shoqërisë civile në Shqipëri të përqendruara në fushën kundër KO pasi projektet që synojnë KO janë të pakta. Shumica e të anketuarve e konsideruan rolin e OShC-ve në këtë fushë si të rëndësishëm, por ata kishin vështirësi për të dhënë shembuj të iniciativave të suksesshme kundër KO. OShC-të e përqendruara në mbështetjen e viktimave theksuan se ato kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në ri-integrimin e viktimave të trafikimit gjatë viteve të 90-ta dhe në fillim të viteve të 2000-ta. Disa të anketuar përshkruan aktivitetet e ndërgjegjësimit me të rinjtë si iniciativat e tyre më të suksesshme, ndërsa të tjerët besojnë se OShC-të kanë një rol më të rëndësishëm që shkon përtej aktiviteteve të ndërgjegjësimit, duke përfshirë rolin e tyre si roje vëzhguese në monitorimin dhe avokimin e një performance më të mirë institucionale, si dhe presionin ndaj institucioneve shtetërore në sigurimin e informacionit për qytetarët. Këto iniciativa do të kërkonin burime njerëzore dhe ekspertizë teknike të ndërtuara përmes përpjekjeve të vetëdijshme e jo përmes iniciativave *ad hoc*.

Roli i OShC-ve në këtë fushë ka qenë i dobët, pjesërisht sepse aktivitetet e tyre janë të bazuara në projekte dhe shpesh janë pa vazhdimësi,²⁴ por gjithashtu si rezultat i paqëndrueshmërisë financiare që i bën OShC-të financiarisht të cenuara dhe lehtësisht të ndikuara nga aktorët e tjerë.²⁵ Kontributi i OShC-ve është veçanërisht i rëndësishëm në zonat e thella ku - duke pasur parasysh mungesën e mundësive - të rinjtë janë më të cenuar për t'u bashkuar me grupet e KO. Për këtë, sektori i shoqërisë civile është i pajisur mirë në arsimin e të rinjve duke u ofruar atyre aftësi dhe mundësi për t'i drejtuar ata drejt profesioneve të ligjshme dhe për t'u distancuar nga KO, dhe gjithashtu për t'i dhënë fund tolerancës së shoqërisë ndaj krimit.²⁶

Një kontribut i rëndësishëm drejt angazhimit më të madh të OShC-ve në iniciativat kundër KO është projekti i financuar nga BE-ja CAUSE (Pasuritë e Konfiskuara të Përdorura për Eksperimentime Sociale), iniciativë e parë e këtij lloji në Shqipëri ose BP.²⁷ Objektivi i projektit është të krijojë një model të ripërdorimit të qëndrueshëm të pasurive të konfiskuara nga KO përmes promovimit dhe zhvillimit të kulturës së sipërmarrjes sociale dhe luftës kundër KO. Projekti siguron mundësi, aftësi dhe mbështetje financiare për OShC-të që janë të interesuara në zhvillimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe i bën ato të afta të krijojnë të ardhura dhe të kontribuojnë në ekonominë lokale, por më e rëndësishmja, siç argumentoi një i anketuar,²⁸ ky projekt jep mesazhin se ajo që është vjedhur nga shoqëria do të kthehet.

24 Intervista Nr. (6), me përfaqësuesin e OShC-së në Vlorë (26 gusht 2020).

25 Intervista Nr. (8), me përfaqësuesin e OShC-së në Shkodër (5 Shtator 2020).

26 Intervista Nr. (9), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (7 Shtator 2020).

27 Partnerët Shqipëri, 2020. CAUSE - Pasuritë e Konfiskuara të Përdorura për Eksperimentime Sociale, Tiranë: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

28 Intervista Nr. (10), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (8 Shtator 2020).

Bashkëpunimi

Përshtypja e përbashkët midis të anketuarve është se bashkëpunimi midis OShC-ve në përpjekjet kundër KO është i dobët si rezultat i paqëndrueshmërisë financiare, mungesës së rrjeteve të OShC-ve, mungesës së personelit të OShC-ve, rrezikut që paraqet KO, mungesës së vëmendjes së donatorëve dhe sepse KO perceptohet si fushë pa vend për shoqërinë civile.

Disa pengesa u theksuan në lidhje me bashkëpunimin e OShC-ve. OShC-të e të njëjtave rrjete dhe koalicione kanë bashkëpunim të mirë me njëra-tjetrën, ndërsa bashkëpunimi me OShC-të jashtë këtyre koalicioneve ose rrjeteve është i dobët. Ekziston një pabarazi gjeografike midis OShC-ve - ndërsa OShC-të lokale bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në nivelin kombëtar OShC-të e bazuara në Tiranë dominojnë sektorin dhe ato rrallë angazhojnë OShC-të lokale. Një hendek i tillë qendër kundër periferisë është vërejtur edhe nga hulumtime të tjera mbi këtë temë.²⁹ Mungesa e vazhdimësisë së veprimeve dhe çështjeve në mesin e OShC-ve kundër KO u theksua si një pengesë tjetër për bashkëpunimin e tyre.³⁰

Megjithëse 72% e organizatave janë pjesë e një rrjeti ose koalicioni në Shqipëri,³¹ nuk ka rrjet të OShC-ve kundër KO. Të anketuarit theksuan nevojën për rrjete dhe aleanca në këtë fushë.³² Siç e tha një i anketuar:

“Ekziston një nevojë për të përmirësuar ndarjen e informacionit midis organizatave, bashkëpunimin në formën e projekteve dhe iniciativave të përbashkëta, si dhe koordinimin për të trajnuar organizata jo të specializuara nga organizata të specializuara.”³³

Kapacitetet dhe nevojat e OShC-ve për të bashkëpunuar dhe bashkuar rrjetet kanë një rëndësi të veçantë në kontekstin e amplifikimit të çështjeve të ndërhyrjes dhe avokimit dhe rritjen e ndikimit në publikun e gjerë dhe institucionet vendimmarrëse.

Sfidat

Ekzistojnë disa sfida të identifikuara nga të anketuarit. Siç u përmend në pjesët e mëparshme, paqëndrueshmëria financiare, mungesa e një rrjeti dhe pabarazia gjeografike e bëjnë të vështirë bashkëpunimin midis OShC-ve kundër KO. Këto të shoqëruara me një agjendë të drejtuar nga donatorët dhe mungesa e vazhdimësisë së veprimeve dhe çështjeve midis OShC-ve kundër KO rezultojnë në një prapambetje. Ndërsa një përfaqësues i organizatës joqeveritare të medias argumentoi:

29 Bino dhe të tjerët, 2020. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

30 Intervista Nr. (1), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (21 korrik 2020).

31 Partnerët Shqipëri, 2019. Vlerësimi i kapacitetit dhe nevojave për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, Tiranë: Partnerët Shqipëri.

32 Intervista Nr. (9), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (7 Shtator 2020).

33 Intervista Nr. (3), me përfaqësuesin e OShC-së në Vlorë (3 gusht 2020).

“Detyra jonë është t’i bëjmë çështjet publike, atëherë OShC-të tjera duhet të ndjekin çështjen në sistemin e drejtësisë. Ndryshe nga OShC-të mjedisore, kjo nuk ka ndodhur kurrë më parë me OShC-të kundër KO.”³⁴

Ekziston një perceptim i përbashkët që KO është një çështje që i përket ekskluzivisht sistemit të drejtësisë penale (SDP) me pak rol për kontributin e OShC-ve. Për më tepër, SDP zakonisht nuk ofron informacionin e duhur kur pyetet nga OShC-të, veçanërisht kur ka raste të KO dhe korrupsionit të nivelit të lartë.³⁵ Bashkëpunimi i dobët me SDP është parë si i dyfishtë, nga njëra anë ata nuk i përfillin kritikën, por nga ana tjetër, shumë pak OShC-ë kanë aftësinë për të bërë një vlerësim profesional të performancës së SDP.³⁶

Shumica e OShC-ve kundër KO nuk janë kërcënuar drejtpërdrejt, megjithatë, ato ndjehen të frikësuar, veçanërisht organizatat joqeveritare të mediave kur raportojnë raste hulumtimi të KO dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Ky kërcënim i perceptuar përmendet nga autorë të tjerë³⁷ të cilët shpjegojnë se në shoqëritë autokratike të tilla si në BP, vetëm një grusht njerëzish kontrollojnë ekonominë dhe shpërndarjen e pushtetit politik, dhe në këtë mjedis, hapësira për shoqërinë civile për të ekspozuar rrjetet e KO dhe korrupsionin bëhet më sfiduese.

Perspektiva e drejtësisë penale

Në përgjithësi, OShC-të dhe institucionet qeveritare (lokale dhe qendrore) duhet të rrisin transparencën, besimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëri-tjetrit.³⁸ Gjysma e të anketuarve të këtij raporti pohojnë se rrallë bashkëpunojnë me institucionet e qeverisë qendrore, ndërsa më shumë se një e katërta e tyre pohojnë se nuk kanë fare bashkëpunim. Zbatimi i ligjit, miratimi me kohë i akteve nënligjore dhe rregulloreve dhe implementimi mbeten faktor pengues për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe ndërveprimeve me autoritetet publike.³⁹ Ndërsa në çështjen e KO bashkëpunimi midis OShC-ve dhe institucioneve shtetërore është edhe më i vështirë, duke pasur parasysh infiltrimin e KO në autoritetet shtetërore dhe rrezikun që paraqet.⁴⁰

Disa nga OShC-të që punojnë në mbështetjen e viktimave argumentojnë se SDP nuk arrin të sigurojë informacionin e duhur për viktimat, gjë që çon në ndjenja të pasigurisë, mosbesimit dhe përkeqësimit të shëndetit të viktimave.⁴¹ Për më tepër, disa nga viktimat

34 Intervista Nr. (1), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (21 korrik 2020).

35 Po aty.

36 Intervista Nr. (4), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (29 korrik 2020).

37 Hoxhaj, 2019. Blogs - London School of Economics. [Online]. Në dispozicion në: <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2019/10/30/civil-society-needs-support-to-fight-corruption-and-organized-crimes-c-Crude-organized-in-the-western-balkans/> [Shikuar më 5 tetor 2020].

38 Partnerët Shqipëri, 2019. Vlerësimi i kapacitetit dhe nevojave për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, Tiranë: Partnerët Shqipëri.

39 Bino dhe të tjerët, 2020. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrje në Shqipëri, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

40 Shih Zhilla dhe Lamallari., 2015. Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Organizuar në Shqipëri, Tiranë: Fondacioni i Shoqërisë së Hapur Shqipëri, f. 45-46; shih gjithashtu Hoxhaj, 2019. Blogs - London School of Economics. [Online]. Në dispozicion në: <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2019/10/30/civil-society-needs-support-to-fight-corruption-and-organized-crimes-c-Crude-organized-in-the-western-balkans/>

41 Intervista Nr. (3), me përfaqësuesin e OShC-së në Vlorë (3 gusht 2020).

konsiderojnë tërheqjen e akuzave të tyre për shkak të frikës nga shfrytëzuesit e tyre në industrinë e seksit ose punës,⁴² kështu, ekziston nevoja për ndryshime në qasjen e SDP ndaj viktimave. SDP është përqendruar kryesisht në kryesit e veprës penale dhe neglizhon viktimat, me të cilat kryesisht punojnë OShC-të kundër KO.⁴³

Shpesh imazhi i OShC-ve ndikohet nga narrativet negative si kapja, blerja ose kërkimi i parave, të cilat riprodhohen nga politikanët dhe media⁴⁴, dhe mund të ketë paragjykime të cilat e bëjnë më të vështirë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe SDP-së.⁴⁵ Siç kanë argumentuar më parë autorë të tjerë,⁴⁶ shkëmbimi sistematik i informacionit mund të jetë hapi i parë në rritjen e bashkëpunimit midis OShC-ve në rajon dhe marrëdhëniet e tyre me SDP-në sepse është e rëndësishme që OShC-të të mbajnë një rol monitorues mbi institucionet shtetërore.

Lidhur me sigurinë e mjedisit ku OShC-të veprojnë, shumica e të anketuarve nuk e perceptojnë mjedisin si të sigurt, pavarësisht se nuk janë kërcënuar ose frikësuar drejtpërdrejt nga KO. Organizatat joqeveritare të mediave ndjehen të frikësuara kur raportojnë raste hulumtimi të KO dhe korrupsionit të nivelit të lartë.⁴⁷ Për më tepër, disa nga OShC-të nuk ishin të gatshme të ofronin informacion të detajuar në lidhje me kërcënimet e bëra ndaj tyre. Sidoqoftë, gjetjet nga intervistat sugjerojnë që OShC-të e përfshira në mbështetjen e viktimave marrin kërcënime nga kryesit e krimeve, siç argumentoi një i anketuar,⁴⁸ mungesa e mbrojtjes së përshtatshme të shtetit u mundëson grupeve të KO të kërcënojnë profesionistët e shoqërisë civile.

Konkluzione

Përfshirja e OShC-ve në luftën kundër KO pengohet nga një numër faktorësh të ndërlidhur.

OShC-të nuk janë të përqendruara në luftën kundër KO pasi ato tradicionalisht kanë parë rolin e tyre në përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga donatorë të huaj, të cilët nuk i kanë dhënë prioritet çështjes së luftës kundër KO. Edhe pse kohët e fundit ekziston një qasje më aktive nga donatorët e huaj për këto çështje, iniciativat e tyre janë ende të pamjaftueshme në lidhje me nevojat.

Mungesa e ndërveprimit midis OShC-ve dhe SDP-së për të marrë informacion e bën edhe më të vështirë për OShC-të që të përfshihen në përpjekjet për të luftuar KO. Ky bashkëveprim bëhet edhe më i vështirë pasi OShC-të nuk kanë kapacitet për të kryer hulumtime ose projekte të tjera që ndihmojnë në luftën kundër KO.

42 Po aty.

43 Intervista Nr. (2), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (30 korrik 2020).

44 Fushatat e shpifjeve ose narrativet negative kundër OShC-ve përdoren nga politikanët në Shqipëri, të cilat kanë ndikuar në mbylljen e hapësirës dhe mundësive të tyre për të marrë pjesë në vendimmarrje. Për më shumë shih: Bino dhe të tjerët, 2020. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, f. 21-22

45 Intervista Nr. (10), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (8 Shtator 2020).

46 Amerhauser, 2019. Si mundet shoqëria civile t'i kundërvihet krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor? Vështrime dhe rekomandime nga angazhimet e tryezës së rrumbullakët me aktorët e shoqërisë civile në të gjithë rajonin, Gjenevë: Nisma Globale Kundër Krimit të Organizuar Transnacional.

47 Intervista Nr. (1), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (21 korrik 2020).

48 Intervista Nr. (4), me përfaqësuesin e OShC-së në Tiranë (29 korrik 2020).

Nuk ka rrjet të OShC-ve kundër KO në Shqipëri dhe vetëm disa OShC-ë zbatojnë në mënyrë primare projekte kundër KO. Pothuajse e gjithë puna e tyre është e përqendruar në mbështetjen e viktimave ose parandalimin e krimit, me pak projekte në fushat e monitorimit dhe avokimit të një performance më të mirë institucionale ose hulumtimit të rasteve specifike të KO.

Rekomandime

Të krijohet një rrjet i OShC-ve kundër KO në mënyrë që të rritet bashkëpunimi i tyre në formën e projekteve të përbashkëta, t'i jepet hov rolit të tyre në terren dhe të përmirësohen njohuritë e tyre dhe shkëmbimi i informacionit.

Rrjeti kundër KO duhet të organizojë aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve të cilat janë të nevojshme për OShC-të të cilat punojnë në projekte kundër KO. Trajnimet dhe angazhimet e shtuara arsimore janë të nevojshme për të siguruar ngritjen e kapaciteteve të personelit të OShC-ve në terren.

Donatorët e huaj kanë nevojë t'i japin prioritet çështjes së luftës kundër KO, pasi kjo është çështje thelbësore në vend.

Ekziston një nevojë për të diversifikuar rolin e OShC-ve në hulumtimin e KO në Shqipëri dhe në praktikat institucionale të përdorura për ta luftuar atë. Hulumtimi duhet të përqendrohet në trafikimin e drogës, lidhjet midis politikës, biznesit dhe tregtisë së paligjshme, pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

SDP duhet të jetë më i hapur dhe më bashkëpunues me OShC-të. Është thelbësore për autoritetet që zbatojnë ligjin të ofrojnë siguri për OShC-të kundër KO që zbatojnë projekte kundër KO. Edhe pse shumica e OShC-ve nuk janë kërcënuar drejtpërdrejt, ato ndjehen të frikësuar, veçanërisht organizatat joqeveritare të mediave kur raportojnë raste hulumtimi të KO dhe korrupsionit të nivelit të lartë.

Shoqëria civile duhet të rrisë ndërgjegjësimin në fushën e KO, dhe të ndërtojë një kundërnarrativë, sepse një përqindje e konsiderueshme e të rinjve nuk e perceptojnë atë si domosdoshmërisht të keq.

Interviews

- Interview 1, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (21 July 2020).
- Interview 2, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (30 July 2020).
- Interview 3, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (3 August 2020).
- Interview 4, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (29 July 2020).
- Interview 5, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (20 August 2020).
- Interview 6, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (26 August 2020).
- Interview 8, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (5 September 2020).
- Interview 9, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (7 September 2020).
- Interview 10, 2020. *Anti-OC Efforts of CSOs in Albania* [Interview] (8 September 2020).

Other references

Amerhauser, 2019. *How can civil society counter organized crime in the Western Balkans? Insights and recommendations from roundtable engagements with civil society actors across the region*, Geneva: Global Initiative Against Transnational Organized Crime.

Azizaj and Shehu, 2020. *2019 Civil Society Organization Sustainability Index*, Washington D.C.: United States Agency for International Development (USAID).

Bino et al., 2020. *Civil Society Participation in Decision Making in Albania*, Tirana: Institute for Democracy and Mediation.

Hoxhaj, 2019. *Blogs - London School of Economics*. [Online]
Available at: <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2019/10/30/civil-society-needs-support-to-fight-corruption-and-organised-crime-in-the-western-balkans/>
[Accessed 5 October 2020].

Institute for Democracy and Mediation: "Trust in Governance" Opinion Poll, 2020.
Available at: <https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2019/>

National Resource Center for Civil Society in Albania. *The Road Map towards a More Enabling Environment for Civil Society Development (2019-23)* Retrieved from: <https://resourcecentre.al/sq/2019/07/26/udherrefyesi-per-hartimin-e-politikes-dhe-ma-save-per-nje-mjedis-mundesues-per-zhvillimin-e-shoqerise-civile-2019-2023/>

Official Publication Center., 1995. *Criminal Code of the Republic of Albania*. Tirana: Official Gazette.

Partners Albania, 2019. *Mapping and assessment of civil society organizations' networks in Albania*, Tirana: Partners Albania for Change and Development.

Partners Albania, 2020. *CAUSE - Confiscated Assets used for Social Experimentation*, Tirana: Partners Albania for Change and Development.

Ralchev, 2004. *The role of civil society in fighting corruption and organized crime in Southeast Europe*, Athens: Journal of Southeast European and Black Sea Studies.


Shqiptarja.com, 2018. *Shqiptarja.com*. [Online]

Available at: <https://shqiptarja.com/lajm/tirane-sulmohet-me-arme-banesa-e-gazetares-se-kronikes-klodiana-lala> [Accessed 9 October 2020].

Zhilla and Lamallari, 2015. *Organised Crime Threat Assessment in Albania*, Tirana: Open Society Foundation Albania.

Bosnja dhe Hercegovina

Autorë: **Benjamin Plevljak, Imer Dulaš**



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij studimi empirik është të analizojë përpjekjet dhe ndikimin e shoqërisë civile dhe të përmirësojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) në trajtimin e çështjes së krimit të organizuar (KO) si dhe forcimin e marrëdhënieve midis OShC-ve dhe institucioneve shtetërore në Bosnjë dhe Hercegovinë. Qëllimi është të formulojë rekomandime për të forcuar, mbështetur dhe promovuar më tej OShC-të që merren me KO dhe për të inkurajuar bashkëpunim më të mirë dhe angazhim më të madh në luftën kundër KO në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Lidhur me hulumtimin në tryezë, është përdorur metoda e analizës kualitative të përmbajtjes së dokumenteve për të analizuar kornizën ligjore kombëtare dhe dokumente të tjerë strategjike në lidhje me luftën kundër KO. Intervistat u zhvilluan me 6 përfaqësues të OShC-ve, si dhe me përfaqësues të sistemit të drejtësisë penale përmes një fokus grupi.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk ka numër të madh të OShC-ve që merren me KO, dhe bashkëpunimi midis OShC-ve dhe sistemit të drejtësisë penale mund të përshkruhet si mesatar, dhe se ka disa boshllëqe në koordinimin e ndërsjellë.

Sipas përfaqësuesve, mënyrat në të cilat OShC-të arsimojnë dhe trajnojnë punonjësit e tyre për t'u marrë me KO dhe korrupsionin janë kryesisht trajnime, arsimime, seminare, uebinare, konferenca dhe tubime profesionale. Gjithashtu u theksua se është e nevojshme të përmirësohen kapacitetet njerëzore dhe teknike në drejtim të pajisjeve të TI dhe të rritet njohuria e hulumtuesve në lidhje me KO. Shumë OShC nuk kanë privilegjin e financimit të qëndrueshëm për të mundësuar punonjësit e tyre të specializohen nga afër dhe të merren ekskluzivisht vetëm me KO dhe korrupsionin dhe mjedisi i sigurisë në të cilin ata kryejnë aktivitetet në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin nuk është mjaft i sigurt.

Fokusi kryesor i aktiviteteve të zbatuara nga OShC-të ose rrjetet është parandalimi i KO përmes veprimit si vëzhgues dhe vënia në dukje e mangësive për këtë çështje. Siç shihet nga perspektiva e drejtësisë penale, roli i shoqërisë civile në luftën kundër KO më së shpeshti karakterizohet si luftë përmes mediave, d.m.th. gazetarisë hulumtuese.

Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme në lidhje me pandeminë e koronavirusit, aktivitetet e OShC-ve janë mjaft të kufizuara. Kapacitetet e OShC-ve të caktuara janë ridrejtuar në sfidat e sjella nga Covid-19. Qëllimi i kësaj analize është të përmirësojë kapacitetet e OShC-ve në trajtimin e çështjes së KO dhe të forcojë marrëdhëniet midis OShC-ve dhe institucioneve shtetërore, si dhe të marrë njohuri më të thella për kapacitetet, mundësitë, arsimin dhe sfidat e tyre.

Krimi i organizuar është një nga format e rrezikimit të sigurisë që tërheq më së shumti vëmendjen e pothuajse çdo vendi. Ndikimi negativ në shoqëri dhe në shtet nuk kufizohet ekskluzivisht në vepra specifike kriminale, por në shumicën e rasteve mund të reflektohet edhe në proceset politike dhe ekonomike.

Për sa i përket Bosnjës dhe Hercegovinës, ekziston numër jashtëzakonisht i madh i aktiviteteve të krimit të organizuar, por ndër ato më dominuese janë trafikimi i drogës, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore dhe forma të tjera të krimit të organizuar. Duke marrë parasysh dokumentet e Bashkimit Evropian në lidhje me situatën në BeH, mund të konkludohet se korrupsioni është vazhdimisht një nga fenomenet që tërheq më së shumti vëmendjen në shoqërinë e BeH. Siç thanë ata në dokumentet e tyre lidhur me BeH për 2018, 2019 dhe 2020, korrupsioni është ende shumë i pranishëm dhe është shkak për shqetësim serioz, pasi ndikimi i drejtpërdrejtë politik në jetën e përditshme të qytetarëve është i dukshëm në të gjitha nivelet.

Kjo analizë do të shërbejë për të shqyrtuar marrëdhëniet midis OShC-ve dhe sistemit të drejtësisë penale dhe për të marrë një pamje reale të gjendjes së marrëdhënieve midis tyre.

Në vazhdim të këtij raporti, fokusi është në analizën e kornizave ligjore dhe strategjive në luftën kundër KO, kapacitetet e njohurive dhe praktikat e OShC-ve dhe sistemin e drejtësisë penale, praktikat dhe sfidat me të cilat përballen, dhe nivelin e tyre të bashkëpunimit reciprok.

Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike

Duke marrë parasysh situatën specifike të shtetit dhe rendin kushtetues në Bosnjë dhe Hercegovinë, ekzistojnë katër ligje penale: Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës,¹ Kodi Penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës,² Kodi Penal i Republikës Serbe³ dhe Kodi Penal i Rrethit Brčko.⁴

Gjithashtu, përveç legjislacionit të mësipërm, një nga ligjet më të rëndësishëm për punën dhe aktivitetet e OShC-ve është Ligji për Lirinë e Qasjes në Informata⁵ në BeH. Ky ligj siguron që çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën për qasje në informata nën kontrollin e autoritetit publik, dhe çdo autoritet publik ka detyrim të duhur për të publikuar informata të tilla.

Përveç Kodeve Penale dhe legjislacionit tjetër, një qasje aktive ndaj kësaj çështje është zhvillimi i Vlerësimit të Kërcënimit të Krimit të Organizuar, Strategjive dhe Planeve të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar në BeH,⁶ si dhe Strategjive dhe Planeve të Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit.⁷

1 Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës.

2 Kodi Penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

3 Kodi Penal i Republikës Serbe.

4 Kodi Penal i Rrethit Brčko të Bosnjës dhe Hercegovinës.

5 Ligji për Lirinë e Qasjes në Informata

6 Strategjia për Luftën Kundër Krimit të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë për periudhën 2017-2020. f. 3

7 Strategjia për Luftën Kundër Korrupsionit në Bosnjë dhe Hercegovinë (2015-2019)

Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës ka miratuar katër Strategji për Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe ka gjithashtu Strategjinë për Luftën kundër Korrupsionit në BeH të nxjerrë nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimin e Luftës kundër Korrupsionit.

Ekzistojnë strategji të tjera, si në nivelin shtetëror ashtu edhe në ato të entiteteve, që janë të lidhura ngushtë me luftën kundër KO. Disa prej tyre janë: Strategjia për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në BeH, Strategjia Shtetërore për Kontrollin e Narkotikëve, Parandalimin dhe Luftimin e Abuzimit të Drogës në BeH, Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armëve të Lehta në BeH, etj.

Në të gjitha këto strategji të përmendura, parimet e tyre tregojnë nevojën për përfshirjen e shoqërisë civile në luftën kundër fenomenit të KO.

Ndoshta dy parimet më të rëndësishme në Strategjinë për Luftën kundër Krimin të Organizuar në BeH, janë “parimi i koordinimit dhe bashkëpunimit”, i cili nënkupton që procedurat për të luftuar krimin e organizuar duhet të bazohen në një koncept të vetëm të bashkëpunimit midis sektorëve publik dhe privat, organizatave ndërkombëtare në BeH, shoqërisë civile dhe qytetarëve, si dhe parimit të “sektorit publik dhe privat dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile” - që nënkupton bashkëpunimin aktiv midis sektorëve publik dhe privat me shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare dhe qytetarët.⁸

Si kandidat e mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe si vend i përkushtuar ndaj procesit të integritetit Euro-Atlantik, Bosnja dhe Hercegovina është zotuar që të forcojë sundimin e ligjit dhe të forcojë institucionet në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme.⁹

I Burimet

OShC-të e intervistuar financohen nga donatorë, kështu që mbështetja themelore për kostot institucionale është gjithmonë jashtëzakonisht e dobishme, gjithashtu si sigurimi i më shumë fondeve për rritjen e numrit të hulumtuesve në luftën kundër korrupsionit dhe KO.

Kapaciteti i nevojitur nga OShC-të për të kryer aktivitetet e tyre të përditshme në mënyrë efektive, përfshirë aktivitetet kundër krimin të organizuar dhe për parandalimin e korrupsionit, është arsimimi në fushën e luftës kundër KO.

Lidhur me pyetjen për numrin e punonjësve me orar të plotë, një organizatë nuk iu përgjigj kësaj pyetjeje, ndërsa shumica e atyre që iu përgjigjën kësaj pyetje thanë se kanë nga 1 deri në 5 punonjës me orar të plotë.

8 Strategjia për Luftën Kundër Krimin të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë për periudhën 2017-2020. Parimet për Zhvillimin e Strategjisë, f. 6

9 Studimi i Krimin të Organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, f. 11, Qendra për Studime të Sigurisë

Shumica e organizatave kanë deri në 10 punonjës, bashkëpunëtorë dhe vullnetarë me orare të pjesshme, ndërsa dy prej tyre kanë deri në 20.

1 deri në 5 punonjës merren ekskluzivisht me tema dhe çështje të KO dhe korrupsionit. Lidhur me profesionin e atyre që merren me këtë çështje, ata janë kryesisht hulumtues, ndërsa ka edhe organizata ku përfaqësohen gazetarë, ish zyrtarë policor, praktikues të parandalimit të krimit dhe praktikues të mbështetjes së viktimave.

Aktivitetet e OShC-ve kanë të bëjnë me organizata ndërkombëtare dhe punë në projekte, financimi i të cilave bazohet në grante nga donatorë të ndryshëm. Kapacitetet mund të karakterizohen si simbolike dhe rezultatet me arritje të kufizuar, tha një nga përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë penale duke përshkruar kapacitetet e OShC-ve.

| Njohuria

Përmes intervistave me përfaqësuesit e organizatave, u zbulua se pothuajse të gjitha ato kanë njohuri të shkëlqyera ose të mira në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin e nivelit të lartë. Vetëm një përfaqësues i një organizate deklaroi se organizata e tij ka njohuri mesatare në këto fusha.

Kur pyetën për të përshkruar njohuritë e OShC-ve të tyre mbi përgjegjësitë dhe performancën e sistemit të drejtësisë penale në luftën kundër KO, situata është e njëjtë. Pothuajse të gjithë thanë se njohuritë e tyre ishin të mira ose të shkëlqyera.

Ka edhe raste që personeli është arsimuar në mënyrë të pavarur për këto çështje, dhe kjo është veçanërisht e dukshme gjatë zbatimit të projekteve specifike në lidhje me KO ose korrupsionin. Njohuritë rreth këtij fenomeni varen nga fokusi i punës së OShC-ve. Përmes intervistave, mund të mësohet se punonjësit kryesisht trajnohen për krimin e organizuar dhe korrupsionin përmes arsimit joformal. Hulumtuesit morën pjesë në trajnime të shumta, uebinare, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta në lidhje me çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, të organizuara nga organizata joqeveritare vendase dhe ndërkombëtare.

Sipas perceptimit të përfaqësuesve të institucioneve të së drejtës penale, në lidhje me kapacitetin dhe aftësinë e OShC-ve për t'u marrë me çështjen e fenomenit të KO, fokusi ishte në marrjen e një njohurie të re dhe arsimit shtesë, si dhe njohjen e kornizës ligjore në të cilën ata mund të veprojnë dhe në çfarë niveli lejohen dhe mund të shkojnë hetimet.

Roli i shoqërisë civile në luftën kundër KO u karakterizua nga të gjithë përfaqësuesit si shumë i rëndësishëm. OShC-të duhet të luajnë rol më aktiv në luftimin e këtyre fenomeneve. Shumica e OShC-ve nuk kanë privilegjin e financimit të qëndrueshëm që do t'i lejonte ato të specializohen ngushtë dhe të merren ekskluzivisht me KO dhe korrupsionin.

Iniciativat kundër KO janë më së shpeshti bashkëpunim midis disa OShC-ve, të tilla si konsorciumi ad hoc i OShC-ve për monitorimin e prokurimit publik në sektorin e sigurisë i krijuar në kuadër të projektit "ACroSS".

Siç deklaroi një përfaqësues i BIRN: "Është e vështirë të veçosh vetëm një iniciativë, por si një organizatë mediatike, ne do të dëshironim të theksonim punën e rëndësishme të shumë redaksive, si në BeH ashtu edhe në rajon (zyrat e BIRN, Zhurnal, Fokus dhe Capital në BeH, Qendra për Raportim Hulumtues në BeH dhe Serbi, KRIK në Serbi, etj.) në hetimin dhe raportimin mbi abuzimin e zbuluar institucional dhe publik të pushtetit, zbatimin joadekuat të ligjit, korrupsionin në mesin e punëtorëve publik, etj."

Kur marrim parasysh aktivitetet që OShC-të kryejnë në luftën kundër KO, ato më shpesh përshkruhen si vëzhguese ose bartëse të veprimtarive arsimore. Përveç kësaj, ekzistojnë aktivitete në lidhje me gazetarinë hulumtuese, mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e krimit. Pothuajse të gjitha ato merren shpesh me këto lloje aktivitete dhe vetëm një organizatë deklaroi se ata i zhvillojnë rrallë aktivitetet e përzgjedhura.

Fokusi kryesor i të gjitha aktiviteteve të organizatës është reagimi (parandalimi) rikuperues. Vetëm një organizatë merret gjithashtu me aktivitete vëzhguese.

Zona e krimit në të cilën OShC-të janë më aktive është korrupsioni në lidhje me krimin e organizuar, ndërsa është interesante që asnjë organizatë nuk merret me çështjet e drogës, bixhozit të paligjshëm dhe krimit të pronës, ndërsa sa i përket aktiviteteve të tjera, ato merren me këto çështje pak a shumë deri në një masë.

Disa nga praktikat e OShC-ve janë gjithashtu shkrimi i materialeve arsimore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, të tilla si studime dhe publikime, si dhe organizimi i seminareve, punëtorëve, uebinarëve etj.

Disa organizata ndjekin dhe shqyrtojnë gjykimet e lidhura me korrupsionin, si dhe të gjitha rastet që lidhen me abuzimin e mundshëm dhe të supozuar të pushtetit nga qeveria.

Lidhur me përpjekjet e OShC-ve në luftën kundër KO, të anketuarit kishin pikëpamje të ndryshme, por në përgjithësi, shumica e tyre mendojnë se përpjekjet janë të dobëta ose mesatare. Është interesante që askush nga të anketuarit nuk u përgjigj se përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile janë të shkëlqyera. Kjo mund të reflektohet në faktin se shumica e OShC-ve nuk janë të specializuara ngushtë në luftën kundër krimit të organizuar.

Në fund, sipas përfaqësuesve të intervistuar të OShC-ve, është e nevojshme të rriten përpjekjet e shoqërisë civile në fushat e luftës kundër korrupsionit të lidhura me krimin e organizuar, trafikimin e njerëzve dhe pastrimin e parave.

Bashkëpunimi

Të gjithë përfaqësuesit e OShC-ve u përgjigjën se organizata e tyre është anëtare e rrjeteve të caktuara të organizatave joqeveritare dhe se ata bashkëpunuan me organizata të tjera në projekte që lidhen me KO.

Duke shqyrtuar bashkëpunimin e ndërsjellë të OShC-ve, duket interesante se askush nga të anketuarit nuk mendon se bashkëpunimi midis OShC-ve është i dobët, ndërsa gjysma e tyre mendojnë se bashkëpunimi i tillë është në nivel mesatar. Nga ana tjetër, ka edhe të anketuar që mendojnë se bashkëpunimi i tillë është kryesisht i mirë dhe madje i shkëlqyeshëm.

Sipas shumicës së përfaqësuesve të intervistuar, marrëdhënia midis policisë dhe OShC-ve është e mirë. Duke marrë parasysh që organizatat shpesh merren me çështje të sigurisë, ato deklarojnë se bashkëpunimi me policinë është i shpeshtë. Në këto raste, policia u tregua e gatshme për çdo lloj bashkëpunimi dhe ndihme në zbatimin e projekteve të caktuara.

Sa i përket Prokurorisë, gjysma e të anketuarve e vlerësojnë këtë bashkëpunim si të mirë, ndërsa pjesa tjetër e konsideron marrëdhënien si mesatare dhe madje të dobët. Lidhur me bashkëpunimin me gjykatat, shumica e të anketuarve i konsideruan si mesatare marrëdhëniet e tyre me gjyqësorin. Duke shikuar profilin e organizatave, përfaqësuesit e të cilave u intervistuan, organizata veprimtaritë e së cilës janë brenda fushës së gazetarisë hulumtuese, në përgjithësi ka marrëdhëniet më të dobëta me policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin.

Një nga boshllëqet kryesore midis OShC-ve dhe sistemit të drejtësisë penale është mungesa e komunikimit të dyanshëm. Shumë projekte dhe iniciativa nuk po marrin vëmendjen e duhur nga institucionet shtetërore. Gjithashtu, kur bëhet fjalë për marrjen e informatave nga institucionet shtetërore (deklarata zyrtare ose dokumente), veçanërisht nga ato gjyqësore, ekziston një mungesë e dhënies së përgjigjes dhe vullnetit për të shkëmbyer informata. Kjo mund të nënkuptojë se megjithëse ekziston Ligji për Lirinë e Qasjes në Informata, mund të jetë e nevojshme të sigurohet arsim shtesë për dispozitat e këtij ligji si dhe zbatimin e tyre, si nga OShC-të ashtu edhe nga institucionet shtetërore. Një i anketuar gjithashtu deklaroi se, në përgjithësi, institucionet shtetërore punojnë me shoqërinë civile vetëm në masën që mund të tregohet se një bashkëpunim i tillë ekziston (minimumi i nevojshëm).

Sfidat

Sipas përvojave të përfaqësuesve të intervistuar, boshllëku kryesor në koordinimin dhe bashkëpunimin e OShC-ve është mungesa e një platforme të përbashkët ku ata do të koordinonin aktivitetet e tyre. Shpesh shfaqen ide të ngjashme të projekteve dhe disa aktivitete dhe tema mbivendosen. Një nga përfaqësuesit theksoi se ka simpati të institucioneve shtetërore ndaj OShC-ve të caktuara dhe se institucionet praktikojnë shpalsjen selektive të informatave.

Kur u pyetën nëse ambienti në të cilin OShC-të punojnë është mjaft i sigurt për t'u marrë me çështje të KO dhe korrupsionit, shumica e përfaqësuesve u përgjigjën se mjedisi nuk është mjaft i sigurt dhe se ndonjëherë ka presione të caktuara dhe ndikime politike dhe frikësim të gazetarëve.

Dy përfaqësues u përballën me kërcënime dhe forma të caktuara të frikësimit, dhe theksuan se nevojiten trajnime dhe këshilla shtesë për mbrojtjen, kryesisht në drejtim të mbrojtjes së TI.

Shumica e të anketuarve besojnë se hapësira në të cilën OShC-të veprojnë është zvogëluar dhe se nuk ka mjaft projekte ose grante, veçanërisht ato që lidhen me luftën kundër KO dhe korrupsionit. Është theksuar se një nga arsytet është mungesa e arsimimit dhe njohurive të punonjësve për këtë temë. Ata gjithashtu deklaruan se është e rëndësishme që institucionet zyrtare, shtetërore ose lokale, të fillojnë të shohin OShC-të si partnerë të barabartë në luftën kundër KO dhe korrupsionit, duke respektuar dhe marrë parasysh idetë dhe iniciativat e tyre.

Perspektiva e drejtësisë penale

Pjesëmarrësit e grupit të fokusit i konsiderojnë OShC-të të përbëra kryesisht nga njerëz të rinj dhe të arsimuar që avokojnë për të drejtat e njerëzve “të zakonshëm”, si dhe të pakicave dhe grupeve të cënueshme, dhe se OShC-të ofrojnë mbështetje për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë si tërësi. Duke qenë se publiku ka krijuar perceptim të mosbesimit të qytetarëve në punën e institucioneve shtetërore përgjegjëse për luftimin e krimit të organizuar, në vijë të parë dalin OShC-të të cilat përmes komunikimit me qytetarë “të zakonshëm” mund të marrin informata që do të lejojnë reagimin me kohë të institucioneve kompetente dhe sigurisht rikthimin e besimit të qytetarëve në sundimin e ligjit.

Pjesëmarrësit besojnë se ka nevojë që shoqëria civile, me të gjitha aspektet e saj, të marrë pjesë në luftën kundër KO në përputhje me aftësitë e saj. Shoqëria civile mund të veprojë në mënyrë korrigjuese për drejtësinë penale dhe institucionet e tjera. Ata deklaruan se KO në kohën moderne ka marrë forma më të sofistikuar, kështu që ekziston nevoja për veprim të përbashkët dhe të ndërlidhur.

Sa i përket rolit të shoqërisë civile në luftën kundër KO, roli i tyre më së shpeshti karakterizohet si luftë përmes mediave, d.m.th. gazetari hulumtuese, por duhet të merret parasysh se gazetaria hulumtuese mund të ketë gjithashtu efekt të kundërt në kuptimin që gazetarët mund të publikojnë informata që nuk janë verifikuar dhe që nuk janë të besueshme, dhe në disa raste, mund të ketë prapavijë politike pas tyre.

Kur bëhet fjalë për korrupsionin dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale në fazën e tyre të hershme ose fillestare, ai u theksua si një segment i KO në të cilin roli i OShC-ve është i nevojshëm.

Kur u pyet për iniciativat më të suksesshme të OShC-ve, një pjesëmarrës përmendi se: “Të gjitha iniciativat e iniciuara dhe zbatuara nga shoqëria civile janë domethënëse dhe që synojnë zhvillimin dhe përparimin e vendit tonë në rrugën e tij drejt anëtarësisimit në Bashkimin Evropian. Një nga parakushtet themelore për t'u bashkuar me BE-në është lufta kundër të gjitha llojeve të krimit të organizuar, që do të thotë se çdo iniciativë që kontribuon në një rezultat konkret është ‘më e rëndësishmja dhe më e suksesshmja’”.

Përpjekjet aktuale të shoqërisë civile për të vepruar kundër KO në Bosnjë dhe Hercegovinë, siç shihet nga policia dhe gjyqësori, kanë qenë përpjekje për të arritur një punë më efikase dhe më të drejtë. Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrësit gjithashtu vunë re konkurrencën midis OShC-ve në luftën për projekte dhe financime, dhe kështu ato veprojnë në mënyrë të pakoordinuar. Ata deklarojnë se më shumë mund të arrihet përmes sinergjisë së OShC-ve, përfundoi një nga pjesëmarrësit në grupin e fokusit.

Bashkëpunimi i pjesëmarrësve, si përfaqësues të sistemit të drejtësisë penale dhe OShC-ve, shpesh reflektohet në trajnime, seminare dhe tubime profesionale të organizuara nga OShC-të. U theksua se ky segment i bashkëpunimit është i dobishëm për të dyja palët.

Boshllëku kryesor në bashkëpunimin midis sistemit të drejtësisë penale dhe OShC-ve është pikërisht bashkëpunimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e komunikimit. Siç deklaroi një nga pjesëmarrësit “deri më tani, në punën time, kam pasur kontakte me organizata të shoqërisë civile vetëm përmes trajnimeve të caktuara në fushën e ‘korrupsionit’, të cilat janë një shembull pozitiv i bashkëpunimit, por në parim mendoj se ky segment i bashkëpunimit mund dhe duhet të përmirësohet”.

Kur merret në konsideratë mjedisi i sigurisë në të cilin veprojnë OShC-të, asnjë nga pjesëmarrësit në grupin e fokusit nuk ishte përfshirë në një rast kur dikush po ushtronte presion mbi ta, por sipas një interviste me përfaqësuesit e shoqërisë civile, dy nga përfaqësuesit e OShC-ve u përballën me presion përmes mediave dhe rrjeteve sociale, si dhe padive gjyqësore.

Besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë penale, i cili është dëmtuar nga ngjarje të ndryshme, do të fillojë të rritet, dhe kështu OShC-të do të jenë më të angazhuara në luftën kundër KO.

Konkluzione

OShC-të shpesh përfshihen në luftën kundër KO dhe korrupsionit përmes aktiviteteve të projekteve, por nuk ka shumë prej tyre për të cilat lufta kundër KO është aktiviteti i vetëm i punës. Mund të vërehet se problemi i specializimit të OShC-ve është i pranishëm, gjë që mund të reflektohet në planin afatgjatë mbi problemin e efikasitetit të OShC-ve në luftën kundër KO. Arsyeja është që OShC-të financohen nga projekte dhe grante të cilat nuk janë gjithmonë të përqendruara ekskluzivisht në KO.

Kjo çon në kufizim të kapaciteteve të OShC-ve ku disa organizata kanë mungesë të arsim-it dhe burimeve që do duheshin të përdoren për të trajnuar punonjësit dhe hulumtuesit që të specializohen në temën e luftimit të KO dhe korrupsionit, ndërsa të tjerat kanë njohuri të shkëlqyera mbi çështjet e krimit të organizuar dhe përgjegjësitë dhe punën e sistemit të drejtësisë penale në luftën kundër KO. Mungesa e fondeve të qëndrueshme nuk lejon që punonjësit të specializohen nga afër dhe të merren ekskluzivisht vetëm me KO dhe korrupsionin. Sipas analizës, organizatat e shoqërisë civile kanë kryesisht 1 deri në 5 punonjës që punojnë si hulumtues që merren me çështje të KO dhe korrupsionit.

Shumica e të anketuarve besojnë se mjedisi i sigurisë në të cilin ata kryejnë veprimtari në lidhje me KO dhe korrupsionin nuk është mjaft i sigurt. Disa organizata u përballën me kërcënime dhe forma të caktuara të frikësimit, dhe theksuan se nevojiten trajnime dhe këshilla shtesë për mbrojtjen, kryesisht në drejtim të mbrojtjes së TI.

Lidhur me bashkëpunimin e OShC-ve me sistemin e drejtësisë penale, është e dukshme që bashkëpunimi me policinë dhe prokurorinë është në nivel pak më të lartë sesa bashkëpunimi me gjyqësorin duke pasur parasysh mungesën e dhënies së përgjigjes dhe vullnetit për të shpalosur informata. Kjo kërkon me nxitim sigurimin e arsimimit shtesë mbi dispozitat e Ligjit për Lirinë e Qasjes në Informata, si dhe zbatimin e tij, si për OShC-të ashtu edhe për institucionet publike.

Mungesa e bashkëpunimit dhe besimi i ndërsjellë kanë ndikim si në OShC-të ashtu edhe në sistemin e drejtësisë penale për sa i përket kryerjes sa më të mirë të veprimtarive të tyre.

Siç shihet nga perspektiva e drejtësisë penale, roli i shoqërisë civile në luftën kundër KO karakterizohet më shpesh si luftë përmes gazetarisë hulumtuese dhe aktiviteteve arsimore (seminare, punëtori, publikime etj.).

Niveli i bashkëpunimit dhe besimit do të rritej nëse sistemi i drejtësisë penale me të vërtetë do t'i konsideronte OShC-të si partnerë në luftën kundër krimin të organizuar, sepse OShC-të janë iniciatorët e diametrave pozitivë dhe tregojnë mangësitë dhe mungesat si ato shoqërore ashtu edhe ato të sistemit.

Rekomandime

Është e nevojshme të përmirësohen kapacitetet teknike dhe njerëzore (modernizimi i pajisjeve të TI, hulumtues të specializuar në luftimin e KO).

Të ngritet niveli i arsimit në lidhje me sigurinë e TI (siguria kibernetike).

Të përmirësohet bashkëpunimi dhe të krijohet një qasje më strategjike. Kjo mund të arrihet përmes organizimit më të shpeshtë të takimeve, forumeve dhe punëtorive në mënyrë që të fitohet besimi i ndërsjellë.

Të rriten përpjekjet për të luftuar bashkërisht të gjitha format e krimin të organizuar, veçanërisht korrupsionin, trafikimin e njerëzve dhe pastrimin e parave.

Të sigurohet specializimi i personelit të OShC-ve në luftën kundër krimin të organizuar.

Të ofrohet arsimim shtesë mbi Ligjin për Lirinë e Qasjes në Informata dhe aspekte të tjera të rëndësishme në lidhje me qasjen në informata.

Trajnimi afatgjatë, informimi dhe edukimi i shoqërisë civile mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin duhet të jetë më i shpeshtë.

Besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë penale duhet të forcohet, gjë që mund të arrihet përmes aktiviteteve të OShC-ve.

Ndërtimi i lidhjeve më të forta me rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe mësimin nga praktikat e mira.

Të kontaktohen organizatat dhe ambasadat ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë për të vënë theksin në grante dhe projekte të përqendruara në luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Bibliografija

Council of Ministers of Bosnia and Herzegovina, Strategy for the Fight against Organized Crime in Bosnia and Herzegovina for the period 2017-2020, Sarajevo, September 2017.

Strategy for the fight against Corruption in Bosnia and Herzegovina (2015-2019).

Centre for Security Studies Sarajevo, Study on Organized Crime in Bosnia and Herzegovina, Sarajevo 2014.

Strategy for Combating Trafficking in Human Beings in BiH (2020-2023).

National Strategy for Narcotic Drug Control, Prevention and Suppression of Drug Abuse in BiH (2018-2023).

Strategy for the Control of Small Arms and Light Weapons in BiH (2016-2020).

European Commission, Commission staff working document, Report on Bosnia and Herzegovina for 2018.

Opinion of the Commission on the application of Bosnia and Herzegovina for membership in the European Union 2019.

European Commission, report on Bosnia and Herzegovina for 2020.

Freedom of Access to Information Act of BiH.

Criminal Code of Bosnia and Herzegovina, "Official Gazette of BiH" No. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8 / 10. The Criminal Code of Bosnia and Herzegovina was imposed by a decision of the High Representative and published in the Official Gazette of BiH no. 3/03. These corrections to the imposed law were published in the "Official Gazette of BiH" no. 32/03.


Criminal Code of the Federation of Bosnia and Herzegovina ("Official Gazette of the Federation of BiH", No. 36/2003, 21/2004 - corrigendum, 69/2004, 18/2005, 42/2010, 42/2011, 59/2014, 76/2014, 46/2016 and 75/2017).

Criminal Code of the Republika Srpska (Official Gazette of the RS, No. 49/2003, 108/2004, 37/2006, 73/2010, 1/2012, 67/2013).

Criminal Code of the Brčko District of Bosnia and Herzegovina ("Official Gazette of the Brčko District of BiH", No. 33/2013 - consolidated text, 47/2014 - correction 26/2016, 13/2017 and 50/2018).

Kosova

Autorë: **Plator Avdiu, Shpat Balaj**



Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë përpjekjet aktuale dhe ndikimin e shoqërisë civile të Kosovës në trajtimin e çështjes së KO, identifikimin e qasjeve të suksesshme dhe shqyrtimin e sfidave. Qëllimi është të formulojë rekomandime për të forcuar më tej, mbështetur dhe promovuar OShC-të që merren me KO dhe të frymëzojë angazhim të ri kundër KO në Kosovë. Raporti synon të edukojë palët e interesuara kombëtare se si dhe pse përfshirja në fushën kundër KO krijon ndryshim dhe paraqet përfitimet e një qasjeje të tillë për të gjithë akterët përkatës.

Studimi është përgatitur bazuar në metodat kërkimore kualitative duke përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Prandaj, një analizë e përmbajtjes është kryer duke u përqendruar në aktivitetet e mëposhtme kërkimore: i) analizimi i kornizës aktuale kushtetuese dhe ligjore si dhe dokumenteve strategjike mbi mjedisin e OShC-ve në Kosovë, ii) interpretimi dhe kuptimi i të dhënave nga intervistat mbi punën e OShC-ve në luftimin e KO dhe iii) mbledhja e të dhënave nga fokus grupi i organizuar me profesionistë të së drejtës penale që synojnë të kuptojnë perceptimet e tyre mbi rolin e OShC-ve në luftimin e KO në Kosovë.

Puna e OShC-ve në Kosovë garantohet nga Kushtetuta dhe ligjet përkatëse për lirinë e asociimit në OJQ-të dhe qasjen në dokumentet publike. Kontributi i OShC-ve në nivelin e politikëbërjes dhe proceset e konsultimit publik njihet gjithashtu nga legjislati i vendit. Problemet kryesore në bashkëpunimin midis OShC-ve dhe institucioneve shtetërore siç dëshmohet nga dokumentet aktuale strategjike janë mungesa e pjesëmarrjes adekuate të OShC-ve në formulimin e politikave dhe legjislatit, financimi direkt dhe indirekt i OShC-ve nuk është ende funksional, praktikat e pazhvilluara dhe jotransparente për kontraktimin e shërbimeve publike nga OSHC-të, dhe mungesa e vullnetarizmit në programet e përfitimit publik.

Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike

Korniza kushtetuese dhe ligjore

Puna e organizatave të shoqërisë civile (OShC) në Kosovë sigurohet me dispozita specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 44 garanton lirinë e asociimit e cila “ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate”.¹

Përveç kësaj dispozite të përgjithshme, korniza ligjore në Kosovë rregullon më tej mjedisin e OShC-ve brenda vendit. Në përputhje me këtë, Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (OJQ) i cili hyri në fuqi në prill 2019.² Para hyrjes në fuqi, ligji u kritikua ashpër nga OShC-të në Kosovë për shkak se versionet fillestare të ligjit parashikuan që institucionet mikrofinanciare (të regjistruara si OJQ) mund të privatizojnë kapitalin e fituar si OJQ, kështu që fondet e fituara për interesin e përgjithshëm publik mund të përdoren potencialisht për qëllime private.³ Rekomandimet e shoqërisë civile të mbështetura nga Presidenti i Kosovës⁴ janë marrë parasysh në versionin përfundimtar të ligjit i cili është aktualisht në fuqi.

Ligji përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, operimin, pezullimin, përfundimin, ndalimin e aktiviteteve dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Kosovë.⁵ Ky ligj është i zbatueshëm në mënyrë specifike për OJQ-të në Kosovë, prandaj nuk është i vlefshëm për partitë politike, sindikatat dhe organizatat sindikale, komunitetet fetare, qendrat fetare, ose tempujt, dhe fusha të tjera të rregulluara me ligje specifike.⁶ Ndërsa, institucionet publike nuk ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë e OJQ-ve, dhe te personat që ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e asociimit.⁷ Ligji njeh tri forma se si mund të organizohet OJQ-ja siç janë: i) shoqatë, ii) fondacion dhe iii) institut.⁸

Kontributi i OShC-ve kosovare në nivelin e politikëbërjes dhe proceset e konsultimit publik është i garantuar ligjërisht nga Rregullorja e Qeverisë Nr. 05/2016 për Standartet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik e miratuar në vitin 2016. Ajo synon të promovojë dhe sigurojë një proces të konsultimit publik midis autoriteteve publike, palëve të interesuara dhe publikut, përfshirë OShC-të për një proces të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe

1 Paragrafi 1 i nenit 44, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/KushtetutaeRepublikesseKosoves_nJ4SXNnEAT.pdf.

2 Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Nr. 11/24 Prill 2019. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>.

3 Shefkriu, A. (2018). *Fati i Ligjit për OJQ-të mbetet në duart e deputetëve*. Kallxo.com, 12 dhjetor. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/shkurt/fati-i-ligjit-per-ojq-te-mbetet-ne-duart-e-deputeteve/>.

4 Koha.Net (2018). *Presidenca ia kthen në rishqyrtim Kuvendit ligjin për OJQ-të*. Koha.Net, 24 nëntor. Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/130623/presidenca-ia-kthen-ne-rishqyrtim-kuvendit-ligjin-per-ojq-te/>.

5 Neni 1, Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Nr. 11/24 prill 2019. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>.

6 Po aty, neni 2.

7 Po aty, paragrafi 6 i nenit 13.

8 Po aty, neni 19.

publike.⁹ Pas miratimit të kësaj rregulloreje, Qeveria e Kosovës krijoi platformën online e cila përdoret nga të gjitha autoritetet publike për të identifikuar palët e interesuara për zhvillimin e konsultimeve publike në mënyrë që të zbatojnë dispozitat e rregullores.¹⁰ Qëllimi i platformës është të ndihmojë ministritë dhe agjencitë e Qeverisë për të lehtësuar procesin e konsultimit publik duke përfshirë autoritetet publike dhe joqeveritare, OShC-të dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.¹¹

Korniza strategjike

Strategjia Shtetërore kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022 aktual ka referenca mjaft sipërfaqësore mbi rolin e OShC-ve të Kosovës kundër krimit të organizuar. Strategjia rendit shoqërinë civile në mesin e grupeve të tjera të interesit për bashkëpunim me qeverinë dhe institucionet publike për një parandalim efikas dhe luftë kundër kërcënimeve të krimit të organizuar, megjithëse kjo nënkupton një rol mjaft të përgjithësuar për OShC-të.¹² Për më tepër, ky dokument njeh pjesëmarrjen e OShC-ve në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë për forcimin e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies.¹³ Në këtë drejtim, strategjia i referohet gjithashtu raporteve të OShC-ve që do të merren parasysh brenda proceseve të monitorimit dhe vlerësimit.¹⁴

Nga ana tjetër, Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 ka identifikuar katër probleme kryesore në bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore: i) mungesa e pjesëmarrjes adekuate të OShC-ve në formulimin e politikave dhe legjisllacionit, ii) financimi direkt dhe indirekt i OShC-ve ende nuk është operacional, iii) praktikrat e pazhvilluara dhe jo transparente për kontraktimin OShC-ve për të ofruar shërbime publike, dhe iv) mungesa e vullnetarizmit në programet në interes të publikut.¹⁵ Për shkak të sfidave të sipërpërmendura, strategjia ka vendosur objektiva prioritare në mënyrë që të adresojë problemet aktuale dhe të ketë ndikim në reformat e ndërlidhura të politikave që së bashku mund të kontribuojnë për të krijuar një mjedis më të mirë për shoqërinë civile brenda vendit.¹⁶

9 Paragrafi 1 i nenit 1, Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>.

10 Platforma online për konsultim publik është në dispozicion në: <https://konsultimet.rks-gov.net/>.

11 Platforma e Konsultimit Publik. "Rreth Platformës", në dispozicion në: <https://konsultimet.rks-gov.net/about.php>.

12 Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. (2018). *Strategjia Shtetërore kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit*, f. 7. Në dispozicion në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/48/STATE%20STRATEGY%20AND%20ACTION%20PLAN%20AGAINST%20ORGANIZED%20CRIME%202018%20%E2%80%93%202022.pdf>.

13 Po aty, f. 16.

14 Po aty.

15 Qeveria e Kosovës - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë. (2019). *Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023*, Prishtinë 2019, f. 12. Në dispozicion në: http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_eng_291507.pdf.

16 Po aty, f. 13.

Burimet

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) të cilat janë të angazhuara në temat e kimit të organizuar (KO) dhe korrupsionit të analizuar në këtë dokument, funksionojnë me një numër të personelit që varion prej 10 deri në 40 të punësuar me kohë të plotë. Në shumicën e tyre, të paktën 30% e personelit merren posaçërisht me KO dhe korrupsionin, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga personeli administrativ dhe/ose personeli që mbulon tema të tjera. Nga ana tjetër, organizatat/mediat karakterizohen me një numër më të madh të personelit, mbi 50, megjithatë, për shkak të vëllimit të lartë të punës dhe rasteve që ato mbulojnë, ky numër mbetet i ulët. Rritja e numrit të gazetarëve hulumtues mbetet sfida për ta pasiguar fondet aktuale në dispozicion për gazetarinë hulumtuese janë të kufizuara, ndërsa ndihma e qeverisë në këtë drejtim ka qenë deri më tani e diskutueshme dhe e përqendruar në organizata/media që nuk mbulojnë çështjet e KO dhe korrupsionit.¹⁷ Sa i përket kapaciteteve financiare, përkatësisht kapaciteteve operacionale, megjithëse ka burime të ndryshme të financimit në dispozicion, OSHC-të konsiderojnë se ka mungesë të burimeve shtesë të financimit në format e 'granteve institucionale' që do të mbulonin shpenzimet operacionale jashtë kornizës së projekteve aktuale.¹⁸ Një formë e tillë e financimit do të shmangte angazhimin ad-hoc të OSHC-ve në KO dhe korrupsion bazuar në projekte afatshkurtra, duke ngritur kapacitetet e OSHC-ve dhe duke iu mundësuar atyre të krijojnë një qasje të qëndrueshme të bazuar në programe për këto çështje.¹⁹

Sfidat

Një sfida kryesore për OSHC-të, përkatësisht mediat, është se ekziston një mungesë e hulumtimeve të thella dhe të hollësishme në Kosovë në temat e KO dhe korrupsionit për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme dhe një praktike pune të përqendruar në prodhimin e përditshëm të lajmeve.²⁰ Për më tepër, institucionet e drejtësisë penale kanë tendencë të mos publikojnë informacione mbi çështjet e KO dhe korrupsionit, gjë që e komplikon më tej punën e gazetarëve hulumtues që mbulojnë tema të tilla.²¹ Në përgjithësi, OSHC-të në Kosovë konsiderojnë se kanë kapacitete të mjaftueshme dhe adekuate për të menaxhuar dhe zbatuar projekte.²² Në parim, një perceptim i tillë është i pranishëm në OSHC-të që mbulojnë çështjet e KO si dhe të korrupsionit, megjithatë, sfidat në këtë drejtim lindin me mungesën e përqendrimit ekskluziv të OSHC-ve në Kosovë në këto tema; shumica e përfaqësuesve të shoqërisë civile të intervistuar për nevojat e këtij punimi konsiderojnë se OSHC-të në Kosovë nuk janë në përgjithësi të profilizuara. Kjo është për shkak të natyrës së funksionimit të OSHC-ve në Kosovë, aktivitetet e të cilave janë kryesisht të bazuara në projekte, rrjedhimisht duke çuar në një shumëllojshmëri temash të mbuluara nga një organizatë në varësi të interesave të komunitetit të donatorëve përmes thirrjeve të tyre të hapura për projekte.

17 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 12/08/2020, Prishtinë.

18 Intervista Nr. (6) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 10/07/2020, Prishtinë.

19 Po aty.

20 Ahmeti, A (2018), "PRESIONI I PAFUND: Raportimi i mediave të Kosovës për krimin e organizuar dhe korrupsionin", BIRN.

21 Po aty.

22 Hoxha, T. (2016), "The Kosovar Civil Society Index 2016", KCSF, Prishtina, October 2016

Ndërsa organizatat e intervistuarat për këtë punim janë të pozicionuara mirë, të pavarura financiarisht dhe me kapacitete të kënaqshme, ka raste kur organizata të ndryshme kanë mbyllur programe të caktuara ose nuk kanë qëndrueshmëri në mbulimin e temave të caktuara për shkak të pengesave financiare.²³ Qasja e bazuar në projekt është më shumë kërkuese për OSHC-të që merren me mbështetjen e viktimave. Kjo vjen për faktin se përveç ekspertizës, cilësia dhe qasja e lehtë në mjediset e tyre është shumë e rëndësishme për shërbimet që ata ofrojnë, prandaj akomodimi afatgjatë dhe adekuat është një faktor kryesor për efikasitetin e punës së tyre.²⁴

Njohuria

Pavarësisht nga sfidat, OSHC-të konsiderojnë se ato kanë nivel të lartë të njohurive për çështjet e KO dhe korrupsionit, si dhe performancën dhe përgjegjësitë e institucioneve të drejtësisë penale. Shumica dërmuese e personelit të tyre që punojnë në këto tema janë hulumtues dhe/ose gazetarë hulumtues, kryesisht kanë prejardhje juridike. Për më tepër, si pjesë e ekipeve të disa prej organizatave, ka personel kryesor që kanë përfunduar me sukses Jurisprudencën, nivelin më të lartë të procesit të certifikimit për zyrtarët ligjorë në Kosovë.²⁵ Pavarësisht nga niveli i lartë akademik dhe prejardhja e duhur profesionale e personelit në shumë prej këtyre organizatave, ekipi hulumtues nuk ka hasur ndonjë ish-zyrtar publik me prejardhje si prokurorë, gjyqtarë, polic, etj. të angazhuar në to. Ndërsa pothuajse të gjitha këto organizata kryejnë monitorim ditor të institucioneve, kryesisht në rastet e korrupsionit dhe KO në gjykata, përveç personelit të plotë dhe me kohë të pjesshme ata angazhojnë një numër të madh të monitoruesve/vullnetarëve në terren. Sidoqoftë, duke pasur parasysh vëllimin e lartë të rasteve dhe proceseve që kërkojnë monitorim, OSHC-të kanë sfida në rekrutimin e monitoruesve në terren dhe mbajtjen e tyre të angazhuar për periudha më të gjata, përtej zbatimit të projekteve të caktuara, gjë që ndikon në efektivitetin e kërkuar nga organizatat.²⁶

Në mungesë të një mekanizmi zyrtar të konsoliduar mirë që do të siguronte njohuri dhe praktikë për ata që kërkojnë praktikë në sektorin e OJQ-ve, njohuria e përfaqësuesve të OSHC-ve në menaxhimin e sektorit jofitimprurës dhe tema të caktuara varet nga përvoja në këtë sektor dhe burimet e brendshme të organizatave.²⁷ Ndërsa për pjesën e personelit të angazhuar si monitorues ose vullnetarë në terren disa nga organizatat ofrojnë trajnime të rregullta, trajnimi i personelit të rregullt bazohet kryesisht në përvojën e brendshme dhe zhvillimin gradual të personelit brenda organizatave.²⁸ Për më tepër, bashkëpunimi i OSHC-ve me njëra-tjetrën dhe me organizatat ndërkombëtare dhe konsolidimi i rrjeteve dhe partneriteteve të ndryshme, rezulton me organizimin e konferencave, punëtorive dhe aktiviteteve të ndryshme, të cilat, ndër të tjera, shërbejnë për të rritur kapacitetet e personelit.²⁹ Nga ana tjetër, organizatat që ofrojnë mbështetje për viktimat e KO, përveç nivelit profesional me prejardhje nga mjekësia, shërbime sociale, juridiku, etj. i pasurojnë njohuritë e tyre me qasje kolegjiale në rekrutimin dhe trajnimin e personelit, si dhe me qasje ndaj viktimave të KO.³⁰

23 Intervista Nr. (4) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 21/07/2020, Prishtinë.

24 Intervista Nr. (8) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 14/07/2020, Prishtinë.

25 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 12/08/2020, Prishtinë

26 Intervista Nr. (3) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 27/07/2020, Prishtinë.

27 Hoxha, T (2016), "The Kosovar Civil Society Index 2016", KCSF, Prishtinë, tetor 2016

28 Intervista Nr. (4) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 21/07/2020, Prishtinë.

29 Po aty.

30 Intervista Nr. (8) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 14/07/2020, Prishtinë

OShC-të në Kosovë kanë pavarësi të dukshme në funksionimin e tyre dhe në mënyrë aktive avokojnë për një performancë më të mirë institucionale në luftimin e KO dhe korrupsionit. Si një hap shtesë në sigurimin e pavarësisë operacionale, disa OShC kanë integruar ndalimin e qasjes në fondet publike në statutet e tyre.³¹ Sipas OShC-ve, pavarësia e konsiderueshme që ato e ndërtojnë e bën Kosovën një model se si OShC-të avokojnë dhe bëjnë presion mbi Qeverinë [e Kosovës] për të qenë më pak e korruptuar dhe për të luftuar korrupsionin, ndërsa modeli i tillë nuk mund të gjendet në rajon për shkak të mungesës së një aktivizmi të tillë nga OShC-të në rajon.³² Për më tepër, OShC-të konsiderojnë se ato kanë hapësirë të mjaftueshme dhe mjedis të sigurt për të vepruar, ndërsa përveç kërcënimeve rastësore jo serioze kryesisht përmes mediave sociale, ato nuk kanë hasur në ndonjë rrezik të drejtpërdrejtë për shkak të punës së tyre rreth KO dhe çështjeve të korrupsionit.³³ Sidoqoftë, media mbetet më e ndjeshme në këtë drejtim dhe përballet me kërcënime të shpeshta nga qytetarë të pakënaqur me raportimin e tyre deri te zyrtarët publikë që ndërmarrin fushata publike për të diskredituar dhe sulmuar punën e tyre.³⁴ Për më tepër, gazetarët përballet vazhdimisht me thirrje telefonike nga politikanë dhe njerëz me ndikim që përpiqen të ndalojnë botimin e artikujve të caktuar, duke rezultuar me kërcënime serioze dhe sulme fizike.³⁵ Përveç ndërhyrjes nga jashtë, gazetarët gjithashtu përballet me presion të brendshëm në mediat e tyre dhe shpesh janë të detyruar të vetë-censurojnë.³⁶

Shumica e OShC-ve që merren me KO dhe korrupsion operojnë si institute kërkimore/ think tanke (grupe studimore), duke shërbyer si vëzhgues për institucionet që merren me këto çështje dhe zbatojnë një qasje nga lart-poshtë ndaj problemit. Shumica e tyre janë të përqendruar në korrupsion dhe pastrim parash, ndërsa fusha të tjera të KO siç janë shfrytëzimi në industrinë e seksit, shfrytëzimi i punës, kontrabandimi i mallrave, kontrabandimi i migrantëve, krimet kibernetike, krimet ndaj pronës, trafikimi i drogës etj. mbeten pak të mbuluara. Sidoqoftë, organizata të tilla si *Instituti Demokratik i Kosovës (IDK)* dhe *Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)*, përveç komponentëve të hulumtimit dhe avokimit, kanë zbatuar programe që ofrojnë ndihmë juridike falas për qytetarët e prekur nga krimi i organizuar dhe korrupsioni.³⁷ Nga ana tjetër, organizata të tilla si *BIRN Kosova* dhe *Internews Kosova* përmes platformave të tyre mediatike mbulojnë një gamë më të gjerë të fushave të KO.³⁸

Krahas vetë-iniciativave të OShC-ve të ndryshme të cilat kanë rezultuar në rritjen e transparencës së institucioneve të tilla si publikimi i shpenzimeve qeveritare, hapja e dosjeve të prokurimit, ngritja e aktakuzave si rezultat i drejtpërdrejtë i raportimit të rasteve të ndryshme të korrupsionit dhe KO nga OShC-të, ka pasur një numër iniciativash të përbashkëta mjaft të suksesshme në këto fusha.³⁹ Një prej tyre është "*Java Kundër Korrupsionit*", një iniciativë vjetore e 11 OShC-ve kryesore të përqendruara

31 Intervista Nr. (4) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 21/07/2020, Prishtinë.

32 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, 12/08/2020.

33 Intervista Nr. (5) me Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, 07/07/2020

34 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, 12/08/2020.

35 Ahmeti, A (2018), "PRESIONI I PAFUND: Raportimi i mediave të Kosovës për krimin e organizuar dhe korrupsionin", BIRN.

36 Po aty.

37 Intervista Nr. (5) & (7) me Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, 07/07/2020 dhe 25/08/2020, Prishtinë.

38 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, 12/08/2020.

39 Po aty.

në luftën kundër korrupsionit dhe KO.⁴⁰ Brenda kësaj iniciative të përbashkët, çdo vit janë në fokus tema të caktuara që kontribuojnë në debatin mbi korrupsionin dhe KO, ndërsa aktivitetet janë të llojllojshme dhe përfshijnë konferenca, dokumentarë, hulumtime, debate publike etj.⁴¹

Bashkëpunimi

OShC-të në Kosovë kanë bashkëpunim të mirë me njëra-tjetrën gjë që ka rezultuar me iniciativa të ndryshme të përbashkëta që kanë ofruar rezultate konkrete për çështje të caktuara, kryesisht të lidhura me korrupsionin. Edhe pse shumica e OShC-ve e konsiderojnë bashkëpunimin e tyre si të mirëfilltë dhe efektiv, qasja e bazuar në projekte në funksionimin e tyre ka krijuar një lloj “gare” që e ka gërryer deri diku këtë bashkëpunim.⁴² Sidoqoftë, përkundër mangësive të herëpashershme në këtë drejtim, për çështje që janë në interes të publikut ekziston një mobilizim efektiv dhe bashkëpunim thelbësor. Për shembull, në vitin 2019, një koalicion i madh i OShC-ve - shumica e të cilave u intervistuan dhe u analizuan për nevojat e këtij dokumenti - protestuan në forma të ndryshme kundër miratimit të ligjit të përditësuar për financimin e partive politike. Përveç reagimeve të përbashkëta me shkrim dhe paraqitjeve në media që kundërshtojnë ligjin përkatës, ka pasur disa veprime dhe protesta simbolike për këtë çështje, të cilat vitet e fundit nuk janë aq të zakonshme për OShC-të në Kosovë.⁴³ Ky bashkëpunim rezultoi të ishte i suksesshëm pasi ligji u tërhoq për shkak të shqetësimeve të ngritura nga OShC-të.⁴⁴

Përveç mbulimit lokal mbi korrupsionin dhe çështjet e KO, OShC-të në Kosovë gjithashtu kontribuojnë në mënyrë rajonale përmes anëtarësimit të tyre në rrjete dhe platforma rajonale dhe ndërkombëtare. Një nga OShC-të kryesore të gazetarisë hulumtuese, BIRN Kosova, jep një kontribut më të gjerë në çështje të tilla përmes anëtarësimit të saj në *Projekti i Raportimit të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (OCCRP)*, një rrjet global që heton korrupsionin dhe KC.⁴⁵ Përveç platformave mediatike, OShC të tjera si p.sh. *KDI* e cila përfaqëson degën e Transparency International në Kosovë, gjithashtu bashkëpunojnë ose janë anëtare të rrjeteve të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare.

Përveç bashkëpunimit me subjekte joqeveritare, OShC-të konsiderojnë se ato kanë bashkëpunim të mirë me institucionet që merren me KO dhe korrupsion si prokuroria, policia dhe gjykatat. Ndërtimi i këtij bashkëpunimi ka qenë një sfidë për OShC-të sepse raportimi i rregullt dhe reagimet mbi shkeljet e ndryshme në këto institucione dhe mos reagimi i tyre ndaj rasteve të caktuara, ka krijuar një perceptim se OShC-të janë një lloj “armiku institucional” dhe raportet e tyre mbi performancën e institucioneve janë

40 Maliqi V. (2019), “Java Kundër Korrupsionit” me korrupsion deri në fyt”, Zëri, 10 dhjetor. Në dispozicion në: <https://zeri.info/aktuale/311428/java-kunder-korrupsionit-me-korrupsion-deri-ne-fyt/>.

41 Po aty.

42 Intervista Nr. (3) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 27/07/2020, Prishtinë.

43 Fana V. (2019), “Shoqëria civile nesër proteston sërish kundër Projektligjit për Financimin e Partive”, Kallxo.com, 20 qershor. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/shkurt/shoqeria-civile-neser-proteston-serish-kunder-projektligjit-per-financimin-e-partive/>.

44 Kqiku A. (2019), “Zmbrapset Qeveria, bie poshtë Ligji për Financimin e Partive Politike”, Zëri, 22 qershor. Në dispozicion në: <https://zeri.info/aktuale/268887/zmbrapset-qeveria-bie-poshte-ligji-per-financimin-e-partive-politike/>.

45 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 12/08/2020, Prishtinë.

tendencioze.⁴⁶ Problemet kryesore të bashkëpunimit të tyre mbeten vonesat dhe ndërlikimet e ndryshme në përgjigjen ndaj kërkesave të OShC-ve për qasje në informacion dhe mos-përgjigje të prokurorisë ndaj denoncimeve publike të OShC-ve në disa raste.⁴⁷ Sidoqoftë, organizata të caktuara kanë krijuar partneritete të drejtpërdrejta me Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatat në fusha të ndryshme si shkëmbimi i informacionit, fushatat e përbashkëta të ndërgjegjësimit, etj. duke ruajtur rolin e tyre mbikëqyrës brenda institucioneve.⁴⁸ Për më tepër, OShC-të janë të angazhuara në shumë procese dhe hartimin e legjislacionit në këto institucione dhe shfrytëzojnë ekspertizën e tyre në zhvillimin e vazhdueshëm të parimeve të qeverisjes së mirë.

Perspektiva e drejtësisë penale

Përfaqësuesit e institucioneve kanë perceptime të ndryshme mbi punën e OShC-ve në luftën kundër KO dhe korrupsionit. Përderisa të gjithë janë unikë në faktin se shoqëria civile është një partner kyç dhe i pazëvendësueshëm në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, ata shprehin pakënaqësi me kritikata që marrin nga OShC-të për punën e tyre. Në lidhje me këtë, ata perceptojnë se mungesa e një profilizimi më të ngushtë ka rezultuar me mungesë të njohurive të thella të OShC-ve mbi performancën institucionale, duke sjellë si rezultat prodhimin e raporteve të ndryshme kërkimore që nuk pasqyrojnë realitetin e punës së tyre dhe kanë dëmtuar imazhin e tyre.⁴⁹ Ata deklarojnë se përveç mashtimit të audiencës lokale në disa raste, OShC-të janë partner shumë i besueshëm dhe kredibil i pranisë ndërkombëtare në Kosovë, gjithashtu kanë ndikuar në reflektimin negativ të Kosovës në raporte të ndryshme ndërkombëtare siç është Raporti për Praktikata e të Drejtave të Njeriut i Departamentit të Shtetit i SHBA-ve.⁵⁰ Për më tepër, ata konsiderojnë se OShC-të gjithashtu kanë keqinterpretuar raporte të tilla në analizën e tyre, duke krijuar perceptim të gabuar ndaj institucioneve.

Pavarësisht rezervave të tyre, përfaqësuesit e institucioneve vlerësojnë shumë bashkëpunimin e OShC-ve në disa fusha. Ata konsiderojnë se përveç korrupsionit, OShC-të duhet të përqendrohen më shumë në punën në nivelin e komunitetit, me fokus në viktimat e KO dhe korrupsionit dhe ngritjen e vetëdijes në mesin e komunitetit. Policia e Kosovës ka projekte të përbashkëta me OShC të ndryshme si për ndërhyrje të drejtpërdrejta në ri-integrimin e viktimave të KO ashtu edhe për rritjen e nivelit të integritetit brenda institucionit. Në mënyrë të ngjashme, Prokuroria percepton që OShC-të kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e ndihmës në paraqitjen dhe përmbylljen rasteve të korrupsionit duke siguruar informacion të rëndësishëm rregullisht.⁵¹ Sidoqoftë, përfaqësuesit e Prokurorisë kanë hasur në raste kur fenomeni i korrupsionit nuk ishte kuptuar mirë nga OShC-të, duke rezultuar me disa raste që nuk kanë bazë për hetim dhe mbingarkesë të panevojshme në punën e tyre. Për këtë çështje, ata mirëpresin bashkëpunimin me OShC-të në kryerjen e fushatave të ndryshme për të sqaruar se çfarë është korrupsioni dhe KO dhe roli i prokurorisë në këtë drejtim.⁵²

46 Intervista Nr. (3) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 27/07/2020, Prishtinë.

47 Intervista Nr. (9) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 20/07/2020, Prishtinë.

48 Intervista Nr. (2) me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, 12/08/2020, Prishtinë.

49 Fokus grupi me përfaqësuesit e institucioneve, 26/08/2020, Prishtinë.

50 Po aty.

51 Po aty.

52 Po aty.

Përfaqësuesit e institucioneve arritën në përfundimin se OShC-të duhet të bëjnë një vlerësim të kapaciteteve të tyre dhe të bëjnë rritje të profilizimit të ekspertizës së tyre në temat e korrupsionit dhe KO. Sidoqoftë, në këtë drejtim, ata konsiderojnë se ndërsa puna e OShC-ve kontribuon në reflektimin e brendshëm të institucioneve dhe rezulton në përmirësimin e kapacitetit dhe performancës, OShC-të duhet të marrin parasysh perspektivën e institucioneve për ndërtimin e kapaciteteve.⁵³

Konkluzione

Ky punim hulumtues tregon se OShC-të dhe mediat në Kosovë në përgjithësi kanë kapacitete të mjaftueshme dhe adekuate për të menaxhuar dhe zbatuar projekte kundër KO dhe kundër korrupsionit, megjithatë, shumë pak OShC janë profilizuar në sektor duke pasur parasysh që projektet e zbatuara drejtohen kryesisht nga donatorët. Nga ana tjetër, ato gëzojnë pavarësi në funksionimin e tyre dhe avokojnë në mënyrë aktive për një performancë më të mirë institucionale në terren, ndërsa disa nga OShC-të kanë integruar në statutet e tyre ndalimin e qasjes në fonde publike.

Vlen të përmendet se OShC-të nuk kanë hasur në ndonjë rrezik të drejtpërdrejtë për shkak të punës së tyre në terren, por sektori i medias mbetet më i prekshëm dhe përballet me kërcënime të shpeshta nga qytetarët dhe zyrtarët publikë duke e sulmuar punën e tyre.

Bashkëpunimi i frytshëm midis OShC-ve ka çuar në mobilizim efektiv, siç është iniciativa e vitit 2019 për të kundërshtuar miratimin e ligjit të përditësuar për financimin e partive politike. Bashkëpunimi midis OShC-ve dhe institucioneve shtetërore vlerësohet i mirë edhe pse rruga drejt këtij bashkëpunimi është sfiduar rëndë. Për më tepër, disa OSHC kosovare janë anëtare të rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare kundër KO.

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë shprehur kritika për punën e OShC-ve që punojnë në fushën kundër KO dhe kundër korrupsionit, duke konsideruar kështu që ato nuk janë të profilizuara dhe kanë mungesë të njohurive të thelluara mbi performancën institucionale. Për më tepër, zyrtarët shtetërorë perceptojnë se OShC-të në vend kanë ndikuar në reflektimin negativ të Kosovës në raporte të ndryshme ndërkombëtare. Sidoqoftë, palët e interesuara në mesin e institucioneve shtetërore kanë sugjeruar që përveç korrupsionit, OShC-të duhet të angazhohen edhe për të punuar në nivelin e komunitetit, me fokus në viktimat e krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe rritjen e ndërgjegjësimit në mesin e komunitetit.

53 Po aty.

Rekomandime

OShC-të që punojnë në temat e KO dhe korrupsionit duhet të sigurojnë qëndrueshmëri në mbulimin e temave të tilla përmes krijimit të programeve të qëndrueshme dhe të profilizohen më tej dhe të shmangin angazhimin sipërfaqësor dhe afatshkurtër në tema të ndryshme të projekteve specifike

OShC-të duhet të rrisin iniciativat e përbashkëta dhe të kryejnë aktivitete të përbashkëta në temat e KO dhe korrupsionit me organizatat, rrjetet dhe/ose platformat kombëtare dhe rajonale;

OShC-të duhet të kryejnë një vlerësim të plotë të nevojave sektoriale dhe përmes gjetjeve të vlerësimit të avokojnë te komunitet i donatorëve për adresimin e fondeve të tyre bazuar në nevojat aktuale të OShC-ve, përderisa komuniteti i donatorëve duhet të hartojë projektet e tyre bazuar në nevojat aktuale të OShC-ve që punojnë në fushën kundër KO dhe kundër korrupsionit;

OShC-të duhet të rrisin kapacitetet e tyre kërkimore në fushën kundër KO dhe kundër korrupsionit, prandaj trajnimet dhe angazhimet e rritura arsimore janë të nevojshme për të siguruar profilizimin e personelit të caktuar në këto tema;

Institucionet shtetërore në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë duhet të ofrojnë ndihmë të shtuar për OShC-të kundër KO dhe kundër korrupsionit që mbështesin viktimat në përmirësimin dhe krijimin e stabilitetit të mjediseve dhe ekspertizës së tyre;

Mediat duhet të jenë më të përqendruara në kërkime të hollësishme dhe të hollësishme në temat e KO dhe korrupsionit, ndërsa institucionet e sundimit të ligjit duhet të sigurojnë qasje më të lehtë në të dhënat e KO dhe korrupsionit për të lehtësuar monitorimin dhe hulumtimin e OShC-ve në çështjet e KO dhe kundër korrupsionit;

Institucionet duhet të sigurojnë masa të rritura të sigurisë për mediat që mbulojnë çështjet e KO dhe korrupsionit dhe të jenë më të përqendruara në eliminimin e ndikimit politik në censurimin e publikimeve kërkimore në këto tema.

Bibliografia

Ahmeti, A (2018), "PRESIONI I PAFUND: Raportimi i mediave të Kosovës për krimin e organizuar dhe korrupsionin", BIRN, Prishtina, Kosovo;

Constitution of the Republic of Kosovo. Available at: http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/KushtetutaeRepublikesseKosoves_nJ4SXNnEAT.pdf

Fana V. (2019), "Shoqëria civile nesër proteston sërish kundër Projektligjit për Financimin e Partive", Kallxo.com, Prishtina, Kosovo, available at: <https://kallxo.com/shkurt/shoqeria-civile-neser-proteston-serish-kunder-projektligjit-per-financimin-e-partive/>

Focus group with institutions representatives, 26/08/2020, Prishtina

Government of Kosovo – Office of the Prime Minister/Office on Good Governance. (2019). *Government Strategy for Cooperation with Civil Society 2019-2023*, Prishtina 2019, p. 12. Available at: http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_eng_291507.pdf

Hoxha, T (2016), "The Kosovar Civil Society Index 2016", KCSF, Prishtina, Kosovo;

Interview No. (2) with Civil Society Representatives, 12/08/2020, Prishtina.

Interview No. (3) with Civil Society Representative, 27/07/2020, Prishtina.

Interview No. (4) with Civil Society Representative, 21/07/2020, Prishtina.

Interview No. (5) with Civil Society Representatives, 07/07/2020, Prishtina

Interview No. (6) with Civil Society Representative, 10/07/2020, Prishtina

Interview No. (7) with Civil Society Representatives, 25/08/2020, Prishtina

Interview No. (8) with Civil Society Representative, 14/07/2020, Prishtina

Interview No. (9) with Civil Society Representatives, 20/07/2020, Prishtina

Koha.Net (2018). "Presidenca ia kthen në rishqyrtim Kuvendit ligjin për OJQ-të", Koha. Net, available at: <https://www.koha.net/arberi/130623/presidenca-ia-kthen-ne-rishqyrtim-kuvendit-ligjin-per-ojq-te/>

Kqiku A. (2019), "Zmbrapset Qeveria, bie poshtë Ligji për Financimin e Partive Politike", Zeri, Prishtina, Kosovo, available at: <https://zeri.info/aktuale/268887/zmbrapset-qeveria-bie-poshte-ligji-per-financimin-e-partive-politike/>

Law No. 06/L-043 on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations, No. 11 / 24 April 2019. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>

Maliqi V. (2019), "Java Kundër Korrupsionit" me korrupsion deri në fyt", Zeri, Prishtina, Kosovo, available at: <https://zeri.info/aktuale/311428/java-kunder-korrupsionit-me-korrupsion-deri-ne-fyt/>

Ministry of Internal Affairs of the Republic of Kosovo. (2018). *State Strategy and Action Plan against Organized Crime*. Available at: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/48/STATE%20STRATEGY%20AND%20ACTION%20PLAN%20AGAINST%20ORGANIZED%20CRIME%202018%20%E2%80%93%202022.pdf>

Regulation (GRK) No. 05/2016 on Minimum Standards for Public Consultation Process. Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

Shefkiu, A. (2018). "Fati i Ligjit për OJQ-të mbetet në duart e deputetëve", Kallxo.com, available at: <https://kallxo.com/shkurt/fati-i-ligjit-per-ojq-te-mbetet-ne-duart-e-deputeteve/>



Mali i Zi

Autorë: **Dina Bajramspahić, Dragana Jaćimović**

Krimi i organizuar dhe korrupsioni janë probleme të zakonshme në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke pasur parasysh se Mali i Zi kishte të njëjtën parti qeverisëse për gati 30 vjet, dhe se Raporti i Freedom House i vitit 2020 e vlerësoi Malin e Zi si regjim kalimtar ose hibrid¹, nuk është çudi që ka raporte të shumta ndërkombëtare dhe vendore në të cilat citohet se ky mjedis politik nuk kontribuoi në luftën kundër KO. Edhe pse është një vend i vogël, Mali i Zi njihet si vendi ku lufta midis klaneve të kokainës u përshkallëzua², ku u sulmuan gazetarët që hulumtonin disa raste, dhe si një vend që ka problem serioz me KO³. Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC) në Malin e Zi njihen si pjesë shumë e rëndësishme e shoqërisë sonë, por ato që kritikojnë ndaj problemeve në shoqëri shpesh karakterizoheshin si “armiç të shtetit” nga Qeveria.⁴

Kjo analizë është rezultat i hulumtimit cilësor, që synon të paraqesë përpjekjet e OShC-ve në luftën kundër KO dhe korrupsionit. Duke pasur parasysh që Mali i Zi është një vend i vogël, e njëjta gjë vlen për numrin e OShC-ve të përqendruara në luftën kundër KO dhe korrupsionit. Kjo është arsyeja pse ky hulumtim përfshiu organizata, fusha e punës së të cilave është më e gjerë në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe KO, dhe aktivitetet e të cilave drejtojnë ose indirekt trajtojnë këtë problem. Ka shumë pak organizata që merren në mënyrë rigoroz me KO në Mal të Zi. Një nga arsyet për këtë është kompleksiteti i temës, si dhe ndjeshmëria e saj. Profilët e organizatave të përfshira në hulumtim mbulojnë ato që luftojnë kundër KO dhe korrupsionit përmes aktiviteteve të vëzhgimit, gazetarisë hulumtuese dhe parandalimit të krimit, si dhe përmes mbështetjes dhe arsimit të viktimave. Ekipi hulumtues i IA zhvilloi intervista të thëlluara me përfaqësues të shtatë organizatave dhe puna e shumicës së këtyre organizatave lidhet me mbështetjen e viktimave.

Edhe pse puna e disa organizatave ka të bëjë me KO dhe ato trajtojnë KO, OShC-të, puna e të cilave nuk mbulon në mënyrë rigoroz krimin e organizuar (parandalimin dhe mbështetjen e viktimave), nuk e njohin veten si të përfshira në luftën kundër KO dhe korrupsionit.

Situata me KO në Mal të Zi është shumë e komplikuar pasi ka shumë pretendime se KO është i lidhur si me vendimmarrësit ashtu edhe me strukturat e niveleve të larta në qeveri. Këto lidhje midis qeverisë dhe krimit janë arsyeja pse nuk kishte përparim të rëndësishëm në luftën kundër KO. OShC-të në Mal të Zi synojnë të kontribuojnë për të luftuar kundër KO kryesisht sepse është çështje e interesit publik dhe për të ndikuar që vendimmarrësit të jenë të vetëdijshëm dhe të frikësohen se këto lidhje mund të zbulohen.⁵

1 Freedom House, Nations in transit Report 2020.

2 OCCRP, Bad Blood: [A War Between Montenegrin Cocaine Clans Engulf the Balkans](#), 2020.

3 The Guardian, [Organised crime in Montenegro on rise amid claims of gang links to government](#), 2018.

4 IA, CGO, CRNVO, CEMI, [Montenegro – Reform Leader or Reform Simulacrum](#), 2018.

5 Intervistë e CIN.

Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike

Dokumenti i parë strategjik i miratuar në luftën kundër korrupsionit dhe KO në Mal të Zi ishte Programi për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga viti 2005. Për zbatimin efektiv të tij u miratuan gjithashtu Plani i Veprimit në vitin 2006 dhe Plani i Inovuar i Veprimit në vitin 2008. Në vitin 2007 u krijua gjithashtu Komisioni Kombëtar për të monitoruar zbatimin e tyre, dy përfaqësues të OShC-ve ishin gjithashtu anëtarë të tij. Që nga fillimi, KE deklaroi se *"Administrata vazhdon të tregojë kuptim të pamjaftueshëm të rolit të mirëfilltë të OJQ-ve në një shoqëri demokratike, e cila gjithashtu përfshin kritika ndaj qeverisë"*.⁶

Pas kësaj, kjo fushë u mbulua nga Strategjia për Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit 2010-2014. Ky dokument njohu rolin e shoqërisë civile në luftimin e KO por gjithashtu që vetëm disa nga OShC-të merren me KO dhe korrupsionin dhe për këtë arsye veprimet e tyre kanë efekte të kufizuara.

Në vitin 2015, në mënyrë që të shmanget puna e dyfishtë me një Plan Veprimi për Kapitullin 23, është vendosur që tani për tani të mos ketë strategji dhe plan të ri veprimi⁷. Disa organizata, si MANS, e konsideruan këtë si një vendim politik që synon të zvogëlojë rëndësinë dhe rolin e tyre në Komisionin Kombëtar. Prandaj, MANS nuk bëri kërkesë për pjesëmarrje në Grupet e Punës për Kapitujt 23 dhe 24.

Krahas Raportit Vjetor të Progresit të Komisionit Evropian për vendin tonë, Komisioni Evropian gjithashtu publikon raport punues "non paper" mbi gjendjen e ecurisë në Kapitujt 23 dhe 24. Këto janë dokumente ku mund të gjurmohet se si OShC-të marrin pjesë në luftën kundër KO dhe korrupsionit, si dhe sesi përparon vendi ynë në këtë fushë nga viti në vit. Fatkeqësisht, të njëjtat probleme dhe shenja po përsëriten nga viti në vit në raporte dhe nuk kishte ndonjë përmirësim të dukshëm.⁸ Në ndërkohë, pas tetë viteve të zbatimit, planet e veprimit për këta dy kapituj u vjetruan dhe nuk pasqyrojnë nevojat për reforma. Sidoqoftë, Komisioni Evropian pret që Mali i Zi të përmbushë detyrimet e tij në lidhje me standardet e përkohshme përpara se të fillojë të përgatisë planet e reja të veprimit.

Raporti i fundit i KE 2020⁹ vuri në dukje pak progres në luftën kundër KO por sidoqoftë, Mali i Zi duhet të adresojë disa mangësi sistematike horizontale në sistemin e tij të drejtësisë penale, duke përfshirë mënyrën e trajtimit të rasteve të KO në gjykata. Progres i kufizuar është bërë në luftën kundër korrupsionit dhe ekziston nevoja për vullnet të fortë politik për të adresuar në mënyrë efektive këtë çështje shqetësuese, si dhe për përgjigje të fortë të drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

Ky raport gjithashtu konfirmoi se në shumë raste, pjesëmarrja e OJQ-ve në grupe punuese mbetet formalitet; mungesa e informacionit në kohë, përfshirja dhe hapja ndaj rekomandimeve të tyre i ndalon ato të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes.

6 Komisioni Evropian, [Montenegro 2006 Progress Report](#) (Raporti i Progresit Mali i Zi 2006)

7 Federata Malazeze e Punëdhënësve, [Corruption in Montenegro](#) (Korrupsioni në Malin e Zi) 2016.

8 Instituti Alternativ, [First impressions on Non paper on Chapter 23 and 24](#), (Përshtypjet e para për raportin non paper për Kapitujt 23 dhe 24), qershor 2020

9 Komisioni Evropian, [Montenegro 2020 Progress Report](#) (Raporti i Progresit i Malit të Zi 2020)

Shumica e organizatave që merren me KO në Mal të Zi janë përqendruar në mbështetjen e viktimave. Nga 7 organizatat e intervistuar, vetëm një organizatë përmendi në mënyrë specifike parandalimin e krimit si fokus kryesor të punës së saj në këtë fushë. Dy organizata punojnë përmes hulumtimit të rasteve specifike të KO dhe korrupsionit, dhe i njëjti numër është për organizatat që punojnë në këtë fushë përmes arsimit. Hulumtimi, monitorimi dhe mbrojtja e një performace më të mirë institucionale dhe rezultateve në luftimin e KO - të përcaktuara së bashku si aktivitete vëzhguese, janë aktivitete të tri organizatave. Duke pasur parasysh që organizatat në Mal të Zi mbulojnë kryesisht disa tema dhe punojnë në fusha të ndryshme, pothuajse të gjitha organizatat nuk kryejnë vetëm një nga ato aktivitete, por i kombinojnë ato në punën e tyre. Është i njëjtë numri i organizatave që i shohin aktivitetet e tyre si parandaluese sikurse numri i atyre që i konsiderojnë aktivitetet e tyre si kombinim të përgjigjes konvencionale (uljes) dhe përgjigjes restauruese (parandalimit). Aktivitetet në luftën kundër KO dhe korrupsionit në të gjitha këto forma kryhen çdo ditë.

Kur bëhet fjalë për fushat specifike të KO në të cilat organizatat në Mal të Zi janë më aktive, përgjigjet janë të ndryshme nga organizata në organizatë në varësi të aktiviteteve të tyre. Sipas deklarimeve të tyre, OJQ-të në Mal të Zi nuk janë të specializuara për një fushë të KO por ato trajtojnë shumicën e temave deri në një masë. Organizatat, puna e të cilave është e përqendruar në mbështetjen e viktimave, janë kryesisht aktive në fushën e shfrytëzimit në industrinë e seksit, shfrytëzimit të fuqisë punëtore dhe trafikimit të qenieve njerëzore, përfshirë lypjen e lëmshës. Disa nga këto organizata janë gjithashtu aktive në fushën e drogës, duke siguruar mbështetje për përdoruesit e drogës. Droga, korrupsioni i lidhur me KO, pastrimi i parave, trafiku i armëve, krimi kibernetik dhe puna dhe zhvillimi i grupeve të organizuara kriminale janë fusha të mbuluara nga organizata që punojnë në hulumtimin e rasteve specifike të KO dhe korrupsionit dhe kryerjen e aktiviteteve të vëzhgimit. Kontrabanda me njerëz, mashtrimi i organizuar, shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve natyrore ishin gjithashtu temë e disa artikujve hulumtues.

Të gjitha këto organizata në Mal të Zi kryesisht financohen nga donatorë të huaj - kryesisht nga organizatat dhe fondacionet ndërkombëtare, BE-ja dhe ambasadat. Disa nga këto organizata kanë pasur vetëm disa projekte të financuara nga buxheti i shtetit që kanë të bëjnë me luftën kundër KO dhe korrupsionit.

Një nga problemet e burimeve për OShC-të në Mal të Zi, por jo vetëm për ato që luftojnë KO dhe korrupsionin, është hapësira e punës. Organizatat kryesisht nuk kanë ambientet e tyre dhe duhet të marrin me qira zyra dhe lokale të tjera të nevojshme për punë (p.sh. për strehimore).

Kapacitetet profesionale në luftimin e KO dhe korrupsionit janë padyshim një çështje në të cilën duhet të punohet, si dhe burimet njerëzore. Një nga përfaqësuesit e OJQ-ve deklaroi: *"Fatkeqësisht, nuk mund të kemi një gazetar/hulumtues që merret vetëm me një temë. Ne do të dëshironim të kishim ata gazetarë profesionistë me fokus të ngushtë në këtë fushë, sepse fokusi është shumë i gjerë."*¹⁰

10 Intervistë e CIN.

Organizatat që merren me KO në Mal të Zi janë kryesisht shumë të vogla. Ekziston vetëm një organizatë që ka më shumë se 20 punonjës, por të gjithë ata nuk janë të përfshirë në aktivitete në lidhje me KO. Organizata të tjera vëzhguese që punojnë në këtë zonë kanë të punësuar nga 6-10 persona. Në varësi të organizatës, numri i punonjësve që merren me temën e KO shkon kryesisht nga një deri në pesë.

Në organizatat që kryejnë aktivitete vëzhguese dhe gazetari hulumtuese kryesisht punojnë hulumtues dhe gazetarë, ndërsa nga ana tjetër organizatat e tjera më së shumti punësojnë praktikues të mbështetjes së viktimave. Nuk ka asnjë ish zyrtar policie, ish prokuror ose ish gjykatës që punon në ndonjë prej këtyre organizatave, por nganjëherë ato punësojnë avokatë për aktivitete të veçanta.

Njohuria

OSHC-të e intervistuar nga Mali i Zi kryesisht i vlerësojnë njohuritë ose kapacitetet e tyre në temën e KO si të mira ose mesatare. Vetëm një organizatë deklaroi se ata kanë njohuri të shkëlqyera në lidhje me mbështetjen e viktimave, por jo në KO si tërësi. Sidoqoftë, një organizatë tjetër që siguron mbështetjen e viktimave vlerëson njohuritë e saj si shumë të dobëta në temën e KO.

OSHC-të malazeze kanë njohuri të mira mbi përgjegjësitë aktuale dhe performancën e sistemit të drejtësisë penale në luftën kundër KO. Kjo njohuri është në nivelin e dobët vetëm për ato organizata që ofrojnë mbështetje për viktimat.

Organizatrat që kryejnë aktivitete vëzhguese dhe gazetari hulumtuese kryesisht fitojnë njohuri mbi trajnimet dhe punëtoritë e organizuara nga organizata ndërkombëtare si OCCRP, Transparency International, DCAF dhe UNODC. Këto trajnime janë shumë të rëndësishme dhe të dobishme, veçanërisht mësimi i teknikave të reja hulumtuese. Gjithashtu, organizohen trajnime të rregullta për punonjësit e rinj. Punonjësit në organizata kryesisht azhurnojnë njohuritë e tyre në seminare dhe trajnime të organizuara nga organizata të tjera.

Praktikat

Roli i OSHC-ve në luftën kundër KO dhe korrupsionit është shumë vendimtar në Malin e Zi. Ato luajnë rolin kryesor kur bëhet fjalë për hulumtimin dhe zbulimin e rasteve penale që Qeveria dhe institucionet kompetente nuk janë të gatshme t'i ndjekin. Edhe pse OSHC-të përdorin metoda të ndryshme, ato njihen si një nga aktorët në shoqëri falë të cilave u zbuluan aferat dhe historitë më të mëdha në fushën e KO dhe korrupsionit.

Një nga përfaqësuesit e OJQ-ve deklaroi se: "Duke pasur parasysh që një numër i madh i rasteve në lidhje me KO dhe korrupsionin ishin iniciuar dhe zbuluar nga OSHC-të, mund të konkludojmë se ekziston personel profesional në këtë sektor"¹¹

11 Intervistë e CAZAS.

OShC-të malazeze janë shumë aktive si në hulumtimin e dobësive institucionale në luftën kundër KO dhe korrupsionit, ashtu edhe në punën në raste specifike kriminale. Ato gjithashtu avokojnë për ndryshimet e nevojshme të ligjit në mënyrë që të rrisin punën e institucioneve në këtë fushë.

Qasja e lirë në informata është një nga mjetet që është shumë domethënës për punën e OShC-ve. Sidoqoftë, situata në këtë fushë është duke u bërë shumë më e keqe sesa më parë dhe kjo është deklaruar si një nga çështjet më të mëdha me të cilat OShC-të po përballen në periudhën e fundit. Ndryshimet e propozuara futin kufizime të reja dhe ulin në mënyrë drastike transparencën e institucioneve, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Ndryshimet përjashtojnë plotësisht sektorin e inteligjencës dhe të sigurisë, si dhe çdo informacion që Qeveria vendos se është konfidencial. Nëse ky ndryshim miratohet, OShC-të që merren me KO do të kenë problem të marrin dokumentacion ose ndonjë informacion nga ky sektor. Kjo është ende çështje e hapur në Malin e Zi, pasi Qeveria e ka shtyrë debatin publik mbi këto ndryshime me kërkesën e OShC-ve¹².

Është gjithashtu e rëndësishme të vërehet se kur ekziston një çështje e rëndësishme, OShC-të malazeze janë të hapura për bashkëpunim dhe bashkim të përpjekjeve, si në rastin e përmendur më lart kur pothuajse 50 organizata kërkuan nga Qeveria të ndalojë miratimin e Ligjit problematik¹³.

Edhe pse lidhshmëria kryesore e punës së OShC-ve është në sigurimin e analizave kritike të punës së institucioneve, një nga rolet shumë të rëndësishme është gjithashtu vendosja në agjendë e gjërave që i shqetësojnë shumicën e qytetarëve të këtij vendi dhe çfarë duhet të diskutohet për të gjetur zgjidhjet e duhura. OJQ-të malazeze janë shumë të dukshme në media dhe për këtë arsye janë të suksesshme në fillimin e debateve të rëndësishme.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se situata në Mal të Zi tregon se pritjet e njerëzve nga sektori i OJQ-ve janë të mëdha dhe nganjëherë joreale. OJQ-të perceptohen si dikush që duhet të jetë gjithmonë aty, për të reaguar dhe vepruar për gjithçka, ndonjëherë edhe për gjërat që duhet të bëjnë vetëm institucionet, siç janë mbrojtja dhe mbështetja në ushtrimin e të drejtave të tyre. Edhe pse shteti ka sistemin dhe institucionet e tij, veçanërisht Prokurorinë dhe Gjqësorin, përmes të cilave mund të zbulojë raste të KO dhe të ndjekë kriminelët, OJQ-të ndonjëherë punojnë në vend të institucioneve për shkak të mungesës së vullnetit politik për të trajtuar rastet më të rëndësishme.

Kur bëhet fjalë për nismën më të suksesshme të iniciuar nga OShC-të në nivel rajonal ose kombëtar, përfaqësuesit e OJQ-ve të intervistuar dhanë përgjigje shumë të ndryshme, por ata kryesisht mendojnë se suksesin më të madh e kishin organizatat që punonin në fushën e mbështetjes së viktimave.

Në nivelin kombëtar, ruajtja e *Lumit Tara*, të njohur si '*Loti i Evropës*', nga shkatërrimi ishte një nga përgjigjet më të zakonshme të lidhura me iniciativën e suksesshme të OShC-ve. OShC-të dhe media arritën të ndalonin përmbytjen e Grykës së Lumit Tara dhe të ndalonin ndërtimin e hidrocentralit.¹⁴ Edhe nëse ky veprim tingëllon si iniciativë në

12 Letër e Hapur e OShC-ve, në <http://bit.ly/3pidOGu>

13 [Almost 50 NGOs and media representatives demanded that Government give up on proposed changes](#) (Pothuajse 50 OJQ dhe përfaqësues të medias kërkuan që Qeveria të heqë dorë nga ndryshimet e propozuara)

14 Durmitor, [Chronology of the public campaign "I do not want a puddle, I want Tara"](#) (Kronologji e fushatës publike "Unë nuk dua një pellg, unë dua Tarën")

lidhje me mjedisin, ky projekt u shënuar gjithashtu si i lidhur me korrupsionin. Ky projekt u mbështet nga lobet energjetike dhe ndihmësit e tyre nga qeveria, ku interesi publik i ishte nënshtruar interesit privat.¹⁵

Një aksion tjetër i suksesshëm ishte ruajtja e Kripores së Ulqinit dhe ndërprerja e vendimit për shkatërrimin e saj dhe ndërtimin e një kompleksi turistik. Pas këtij projekti ishte një nga biznesmenët e njohur si i diskutueshëm dhe me lidhje të forta politike. Aksioni u iniciua gjithashtu nga OJQ-të, aktivistët e medias dhe ata lokalë.¹⁶

Kur bëhet fjalë për iniciativë të lidhura ngushtë me krimin e organizuar ose korrupsionin, shumica e tyre iniciohen nga OJQ MANS. Nisma të tjera të rëndësishme janë gjithashtu lansimi i qendrave të thirrjes për viktimat e dhunës, shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe të ngjashme. Si iniciativë e suksesshme nga rajoni, hulumtimi i BIRN për projektin 'Shkupi 2014' u përmend nga organizatat e intervistuar. Kostoja e pamjes së re të Shkupit është rritur shtatë herë nga shuma e planifikuar fillimisht ndërsa numri i monumenteve dhe ndërtesave është trefishuar dhe ky hetim tregoi parregullsi dhe afërsisht të shumta.¹⁷

Përpjekjet aktuale të shoqërisë civile në Mal të Zi për të trajtuar temën e luftimit të krimit të organizuar vlerësohen kryesisht si të mira. Tri nga shtatë organizatat i matën (cilësuan) përpjekjet e OSHC-ve si të mira, dhe dy prej tyre si mesatare. Vetëm një organizatë deklaroi se këto përpjekje janë të shkëlqyera, ndërsa në anën tjetër ekziston gjithashtu një organizatë që i sheh këto përpjekje si shumë të dobëta.

Bashkëpunimi

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin midis OSHC-ve që merren me KO, kemi gjetur se në nivelin kombëtar të gjitha organizatat ranë dakord se bashkëpunimi është i mirë. Por, në nivelin rajonal vetëm disa organizata konfirmuan anëtarësimin ose pjesëmarrjen në ndonjë rrjet rajonal ose projekt kundër KO, të tilla si Koalicioni UNCAC, OCCRP, Transparency international, dhe Rrjeti Global i Gazetarisë Hulumtuese. Organizatat gjithashtu përmendën anëtarësimin në iniciativat rajonale të orientuara posaçërisht në fushën e tyre kryesore të punës të tilla si strehimoret për viktimat, rrjetet e organizatave të grave,¹⁸ etj.

OSHC-të nuk kanë të njëjtën përvojë në bashkëpunim me institucionet që merren me KO. Duke pasur parasysh fushën e punës dhe aktivitetet e ndryshme që kryejnë OSHC-të, ne e ndamë çështjen e bashkëpunimit me Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat, veçmas, duke e vlerësuar atë nga 'shumë e dobët' deri në 'shumë e mirë'. Përgjigjet ishin të ndryshme në varësi të llojit të aktiviteteve që OSHC-të kryejnë. Organizatat e orientuara në aktivitete vëzhguese ose gazetari hulumtuese vlerësuan bashkëpunimin me Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat njësoj - si *shumë të dobët* dhe *të dobët*. 'Mirë' është nota më e lartë për bashkëpunim me këto institucione, dhënë nga organizatat, puna e të cilave është e orientuar kryesisht në parandalimin e krimit, si dhe në arsim. Organizatat, aktivitetet e të cilave kanë të bëjnë me mbështetjen e viktimave, janë pak më pozitive për këtë bashkëpunim. Bashkëpunimi me policinë vlerësohet si *i mirë* dhe *mesatar*, me prokurorinë si *i dobët*, ndërsa bashkëpunimi me gjykatat vlerësohet si *i dobët* dhe *shumë i dobët*.

15 Gjeni më shumë këtu <http://bit.ly/3og2MQL> dhe në këtë link <http://bit.ly/2YepgHr>

16 REL, Prokuroria duhet të hetojë rastin e Kripores

17 Ngjarja hulumtuese e BIRN në dispozicion në: <https://bit.ly/3oe4qCv>

18 [The Advocates for Human Rights](#) (Avokatet e të Drejtave të Njeriut), [WAVE](#), [ASTRA](#), etj.

Sidoqoftë, OJQ-të malazeze kontribuan shumë në forcimin e sistemit të drejtësisë. Një nga projektet rajonale në atë drejtim u zbatua nga Instituti Alternativ dhe Shoqata e Prokurorëve të Serbisë. Qëllimi kryesor i projektit ishte të mbështesë administrimin efikas dhe efektiv të sistemit të drejtësisë penale në Serbi dhe Mal të Zi përmes shkëmbimit të përvojës rajonale dhe zbatimit të suksesshëm të hetimit prokurorial të prezantuar me legjislacionet e reja të Procedurës Penale¹⁹. Puna e projektit u përqendrua kryesisht në përmirësimin e bashkëpunimit të aktorëve relevantë në procedurën penale duke identifikuar mangësitë aktuale dhe fillimin e bashkëpunimit të mirë midis prokurorëve publik dhe policisë si palë kryesore të interesit në fazën parajyqësore.

Sfidat

Rrjetëzimi i pamjaftueshëm është deklaruar si një nga boshllëqet në bashkëpunim midis dhe ndërmjet OShC-ve në Mal të Zi. Një nga përfaqësuesit e OJQ-ve deklaroi:

“Zakonisht organizatat kanë një partner të përhershëm të cilin ato rrallë e ndërrojnë ose janë disi të përqendruara te vetja, dhe organizatat e tjera janë pjesë e disa rrjeteve të vogla rajonale ku askush tjetër nuk mund të anëtarësohet”²⁰

Si dobësi më e madhe për bashkëpunimin midis OShC-ve, organizatat e intervistuar deklaruan rivalitetin ose orientimin e projekteve të organizatave, pasi që të gjitha aktivitetet kryesisht kalojnë nëpër projekte. Hapësira për të aplikuar dhe garuar për të marrë projekte është disi një arenë ku ato organizata luftojnë kundër njëra-tjetrës. Për t'u bashkuar në projekte të mëdha, specifike dhe ndërkombëtare, organizatat më së shumti kanë nevojë për përvojën e mëparshme në menaxhimin e fondeve të mëdha në llogaritë e tyre, të cilat zakonisht organizatat e nivelit të mesëm nuk mund t'i përballojnë.

Një arsye tjetër e mungesës së bashkëpunimit midis OShC-ve është qasja e ashtuquajtur “pak nga çdo gjë”. Gjegjësisht, shumë organizata me mungesë të kapaciteteve mbulojnë fusha që nuk kanë lidhje me misionin e tyre. Shkak i mundshëm për këtë qasje është gara për projekte e përmendur më parë. Siç deklaroi një nga përfaqësuesit e OShC-ve:

“Pavarësisht nga fakti që sektori i OJQ-ve në vendin tonë po rritet, ekziston numër në rënie i organizatave të profilizuara ngushtë, gjë që është problem për bashkëpunimin efikas dhe rrjetëzimin e bazuar në parime.”²¹

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin midis OShC-ve dhe sistemit të drejtësisë penale, sfida më e madhe është se ky sistem është shumë i mbyllur dhe nuk dëshiron të ndajë informacion në lidhje me punën e tij.

Institucionet nuk i perceptojnë OShC-të si partnerë dhe dikë që mund t'i ndihmojë ato të përmirësojnë punën e tyre dhe situatën e përgjithshme në Mal të Zi. Për më tepër, ato nuk i shohin OShC-të si mjaft profesionale dhe kompetente për t'u marrë me këtë fushë. Institucionet kryesisht nuk e njohin kontributin e OShC-ve. Mungesa e besimit shprehet fuqimisht kur bëhet fjalë për këto dy segmente të shoqërisë që kanë të njëjtin mision.

19 Më shumë në publikimin: [Six Years of Prosecutorial Investigation in Montenegro](#) (Gjashtë vjet hetim prokurorial në Mal të Zi)

20 Intervistë e CIN

21 Intervistë e CAZAS

“Ne kemi një mosbesim të fortë ndaj institucioneve të sistemit në lidhje me shoqërinë civile dhe anasjelltas, dhe për mendimin tim nuk duhet të jetë kështu.”²²

Bashkëpunimi ekziston por bazohet në disa aktivitete ad hoc, nga projekti në projekt ose nga ngjarja në ngjarje. Si problem për bashkëpunim, përfaqësuesit e OJQ-ve gjithashtu përmendën që OShC-të nuk perceptohen si sektor por si një ose dy grupe njerëzish.

Një mjedis në të cilin vepron shoqëria civile nuk është mjaft i sigurt për të punuar në luftën kundër KO dhe korrupsionit në Malin e Zi.

“Thjesht, mjedisi nuk është i sigurt në kuptimin që dikush që flet publikisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin mund të jetë i sigurt se ai/ajo nuk do të ketë një lloj dënimi për këtë. Nga përvojat e hulumtimeve të ndryshme dhe gazetarëve që punojnë në ngjarje rreth nivelit të lartë në Mal të Zi mund të shohim se nuk është e sigurt të punosh. Shumë kohë pasi u publikuan këto ngjarje, këto raste nuk janë zgjidhur ende.”²³

Kur bëhet fjalë për shkeljen e të drejtave të tyre, deri më tani, OShC-të malazeze dhe përfaqësuesit e tyre përballëshin me përgjime të paligjshme, ndërprerje të paligjshme të komunikimit, shpime të gomave, kërcënime përmes mesazheve, e-mailit, në mënyrë indirekte dhe në komunikim të drejtpërdrejtë, etj. Punonjësit e OJQ-ve shpesh janë fyer dhe reputacioni i tyre është dëmtuar. Anëtarët e familjeve të tyre janë keqtrajtuar, pushuar nga puna, etj.

Për OShC-të është veçanërisht e rëndësishme që të ketë trajnime se si të mbrohen të dhënat e mbledhura, kompjuterët dhe bazat e të dhënave, por edhe se si të merren me kërcënimet e lartpërmendura. Kjo është shumë e rëndësishme dhe për organizatat që ofrojnë mbështetje për viktimat, pasi këto organizata kanë baza të të dhënave të brendshme me të dhëna private të përdoruesve të tyre, etj. Trajnimet për mbrojtjen e TI-së janë diçka për të cilën duhet të punohet vazhdimisht, por fatkeqësisht kjo është diçka që nuk është planifikuar brenda buxheteve të tyre në një masë të mjaftueshme. Nga ana tjetër është gjithashtu e paqartë se nga mund të tërhiqen këto fonde pasi kjo çështje nuk është gjithmonë prioritet i donatorëve.

Zyrtarisht, shumë organizata janë të përfshira në punën e grupeve dhe organeve të ndryshme punuese, përfshirë ato grupe punuese për kapitujt e negociatave. Por përfshirja e tyre është më e vogël dhe e pabarabartë në praktikë dhe ndryshon nga një grup punues në tjetrin. Nga ana tjetër, OShC-të po bëhen gjithnjë e më të dukshme dhe më të pranishme në media. Sektori i OJQ-ve në Mal të Zi nuk ka qenë kurrë më aktiv sesa vitet e fundit, dhe nganjëherë duket se efektet e tyre janë mjaft të vogla duke pasur parasysh numrin e projekteve dhe përpjekjeve që ato bëjnë.

“Shpesh, OShC-ve nuk u jepen informata ose informata të mjaftueshme për të qenë në gjendje të japin një kontribut domethënës ose puna jonë thjesht shpërfillet.”²⁴

22 Intervistë e Defendology

23 Intervistë e Juventas

24 Intervistë e “SOS Telefon” për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës

Një numër i vogël i organizatave në Mal të Zi e konsiderojnë veten të angazhuara në luftën kundër KO në përgjithësi. Ato organizata puna e të cilave ka ndikim në (parandalim të) KO ose viktimat e tij (mbështetjen e viktimave) nuk e njohin veten si të angazhuara në luftimin e KO dhe korrupsionit. Këto organizata kryesisht financohen nga donatorë ndërkombëtarë. Vetëm disa organizata kanë pasur mbështetjen e shtetit në atë drejtim. Nga buxheti i shtetit kryesisht financohen vetëm disa nga projektet e atyre që ofrojnë mbështetjen e viktimave (strehimore, qëndrimet ditore, etj.). OShC-të në Mal të Zi janë zakonisht të vogla. Organizata me numrin më të madh të punonjësve ka pak më shumë se 20 anëtarë, dhe zakonisht këto organizata kanë 1-5 punonjës që punojnë në KO.

Organizatave në Mal të Zi nuk janë të specializuara për një fushë të KO. Hulumtimi dhe puna në raste konkrete penale, si dhe informimi i publikut mbi këto afere janë mekanizmi më i përdorur në këtë fushë. Edhe pse ambienti për trajtimin e kësaj teme në Mal të Zi është i pasigurt, rastet dhe ngjarjet më të rëndësishme në vendin tonë u zbuluan nga OShC-të. Kur bëhet fjalë për burimet, OShC-të duhet të rrisin numrin e personelit profesional që merret me KO; duhet të rregullojnë problemin e marrjes me qira të hapësirës së punës; dhe duhet të trajnohen, veçanërisht se si të mbrojnë të dhënat e tyre. Për të mësuar dhe për të fituar njohuri të reja, trajnimet më të dobishme janë ato të organizuara nga organizata ndërkombëtare të specializuara në hulumtimin e KO.

Problemi lind kur rastet duhet të procedohen në institucione, pasi që numri i madh i rasteve lidhet me përfaqësues të lartë dhe këto procese gjyqësore shpesh presin në sirtar derisa të vjetrohen. Kjo është gjithashtu një arsye pse OShC-të që hulumtojnë raste specifike e vlerësojnë bashkëpunimin me sistemin e drejtësisë penale si shumë të dobët. Sulmet e pazgjidhura ndaj gazetarëve dhe hulumtuesve të tjerë në fushën e KO, si dhe mungesa e sundimit të ligjit dhe transparencës në institucione gjithashtu kontribuan në krijimin e një hendeku më të madh midis këtyre dy aktorëve në shoqëri. Mosbesimi nga të dy palët është padyshim problemi më i madh për bashkëpunimin mes tyre.

Autoritetet shtetërore duhet të krijojnë parakushte për një numër më të madh të OShC-ve për të hulumtuar KO në përgjithësi, veçanërisht duke përmirësuar zbatimin e ligjit për liri të informacionit.

Donatorët duhet të ofrojnë më shumë mbështetje dhe të mundësojnë specializimin e OJQ-ve të gatshme për të punuar në fushën e krimit të organizuar.

OShC-të duhet të rrisin ndërtimin e kapaciteteve të tyre në fushën e ballafaqimit me KO, dhe posaçërisht të rrisin numrin e personelit profesional që merret me KO.

OShC-të duhet të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre në mënyrë që të kenë ndikim më të madh në institucione. Ato gjithashtu duhet të kenë komunikim të vazhdueshëm me mediat dhe të kenë veprime të përbashkëta për të bërë që deklaratat e tyre të arrijnë një numër më të madh të qytetarëve dhe të publikut.

Institucionet duhet të zgjidhin sulmet ndaj gazetarëve dhe hulumtuesve si dhe t'u mundësojnë OShC-ve të bëjnë punën e tyre pa pasur frikë se do të kërcënohen. Kjo do të përmirësojë besimin tek institucionet gjë që do të çojë në bashkëpunim më të mirë midis tyre.

Institucionet duhet të jenë më proaktive në zgjidhjen e kallëzimeve penale të paraqitura nga OShC-të në lidhje me KO dhe të kompletojnë rastet deri në fund, në përputhje me ligjin.

Institucionet duhet të përmirësojnë transparencën e punës së tyre si dhe t'u mundësojë OShC-ve dhe publikut që të marrin informacion prej tyre dhe të mos ngushtojnë hapësirën për të vepruar dhe përdorur mjete, siç është qasja e lirë në informacion.

Sistemi i drejtësisë penale duhet të njohë OShC-të si partnere në luftën kundër KO dhe korrupsionit.

Duhet të ketë shkëmbim më të mirë të të dhënave midis OShC-ve në nivel kombëtar, por edhe në atë rajonal, pasi që KO në Ballkanin Perëndimor po i kalon kufijtë; kjo do të ndihmojë për të pasur një pikëpamje më të gjerë të përhapjes së KO.

Institute Alternative, Centre for Civic Education, Centre for Development of NGOs, and Centre for Monitoring and Research, (2018), at: <http://bit.ly/2KJAgt5>

BIRN, 2015, *True Cost of "Skopje 2014" Revealed*, at: <https://bit.ly/3oe4qCv>

Criminal Code of Montenegro, Official Gazette of Montenegro 70/2003, 13/2004, 47/2006 and Official Gazette of Montenegro 40/2008, 25/2010, 32/2011, 64/2011, 40/2013, 56/2013, 14/2015, 42/2015, 58/2015, 44/2017 and 49/2018

Nenezić, A. and Maraš, V. (2020), *Nations in Transit Report*, Freedom House, at: <http://bit.ly/2YcVFhC>

Dojčinović, S, Jovanović, B. and Đokić S. (2020), *Bad Blood: A War Between Montenegrin Cocaine Clans Engulf the Balkans*, OCCRP, 5 May, at: <http://bit.ly/3c2Z0YG>

Walker, S. (2018), *Organized crime in Montenegro on rise amid claims of gang links to government*, The Guardian, 10 May, at: <http://bit.ly/2Nqteug>

European Commission, 2006, *Montenegro Progress Report*, at: <https://bit.ly/2Y9EM7c>

European Commission, 2020, *Montenegro Progress Report*, at: <https://bit.ly/3mRZmTA>

Montenegrin Employer Federation, 2016, *Corruption in Montenegro*, at: <https://bit.ly/3phtNVt>

Bajramspahić, D. (2020), *First impressions on Non paper on Chapter 23 and 24*, Institute Alternative, 12 June, at: <http://bit.ly/36cf5HP>

Durmitor, (2011), *Chronology of the public campaign "I do not want a puddle, I want Tara"*, at: <http://bit.ly/2KJASpP>

Radio Free Europe, (2015), *Prosecution should investigate Saline case*, at: <http://bit.ly/3iKqk5X>

List of interviews:

Interview 1: MANS The Network for Affirmation of the NGO Sector, interview conducted on 21 July 2020.

Interview 2: Center for Investigative Journalism of Montenegro, interview conducted on 21 July 2020.

Interview 3: Women's Safe House, interview conducted on 21 July 2020.

Interview 4: "SOS Telefon" for Women and Children Victims of Violence Nikšić, interview conducted on 22 July 2020


Interview 5: Juventas, interview conducted on 30 July 2020.

Interview 6: Defendology centre for security, sociological and criminological research of Montenegro, interview conducted on 29 July 2020.

Interview 7: CAZAS, interview conducted on 22 July 2020.

Maqedonia e Veriut

Autorë: **Magdalena Lembovska**



Përmbledhje ekzekutive

Ky punim shqyrton përpjekjet e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të adresuar çështjet e krimit të organizuar (KO) në Maqedoninë e Veriut. Punimi synon të hartëzojë rolet kryesore që OShC-të kanë marrë në luftimin e krimit të organizuar, burimet e tyre, njohuritë dhe kapacitetet për ta bërë këtë, praktikrat e mira ekzistuese dhe bashkëpunimin ndër-sektorial. Punimi gjithashtu identifikon sfidat kryesore në luftimin e KO nga pikëpamja qytetare.

Analiza mbështetet në hulumtimin në tryezë dhe në terren, duke përfshirë shqyrtimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike që rregullojnë punën e shoqërisë civile, raportet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, intervistat elektronike dhe telefonike dhe shqyrtimin e faqeve të internetit të OShC-ve kombëtare. Gjithashtu u zhvillua një konsultim me përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë penale.

Analiza tregon se OShC-të në Maqedoninë e Veriut kanë qenë veçanërisht të interesuara për adresimin e korrupsionit, ndërsa lufta kundër KO nuk ka qenë shumë e popullarizuar. Një pjesë e konsiderueshme e punës së OShC-ve është e strukturuar rreth procesit të integritetit në BE, veçanërisht në lidhje me Kapitullin 23. OShC-të zakonisht marrin rolin e vëzhguesit, pasuar nga aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve dhe mbështetja e viktimave. Sidoqoftë, qëndrueshmëria financiare është sfidë serioze për këtë sektor, duke ndikuar në kapacitetet dhe specializimin e OShC-ve dhe duke rritur konkurrencën në kurriz të bashkëpunimit. Për më tepër, bashkëpunimi me institucionet nga sistemi i drejtësisë penale është sfidues, jo vetëm për shkak të mungesës së traditës dhe besimit, por edhe të kuptimit të pamjaftueshëm të roleve dhe përgjegjësisë të akterëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë.

Në fund, autori ofron një sërë rekomandimesh për OShC-të, institucionet shtetërore dhe komunitetin e donatorëve, që synojnë rritjen e kapaciteteve të OShC-ve, mundësi më të mira për rrjetëzim dhe qasje më të strukturuar drejt adresimit të çështjeve të KO.

Si një nga përpjekjet kryesore për të hartëzuar dhe analizuar angazhimin e shoqërisë civile kundër KO, studimi i tanishëm nuk synon të ofrojë pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha aktiviteteve të OShC-ve në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi është thjesht të hartëzohen praktikrat më të mira dhe sfidat më të ngutshme në mënyrë që të propozohen një sërë rekomandimesh. Ka pasur një përgjigje të kufizuar nga OShC-të, pjesërisht për shkak të faktit se disa OShC nuk e konsideronin veten si “duke punuar në çështje të krimit të organizuar”, edhe pse ato ofrojnë shërbime sociale për grupet në nevojë dhe kryejnë veprimtari edukative. Kjo tregon më tej mungesën e vetëdijes për rolin e OShC-ve në këtë fushë dhe nocionin e përhapur se KO është “çështje e shtetit”.

Shoqëria civile në Maqedoninë e Veriut është dinamike dhe e larmishme. Si e tillë, ajo duhet të luajë rol të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar (KO). Duke vepruar kështu, OShC-të mund të marrin një larmi rolesh: monitorimi i punës së institucioneve dhe rezultatet e tij në luftën kundër KO, duke kontribuar në krijimin e politikave, hetimin dhe analizimin e rasteve specifike, si dhe parandalimin e krimit dhe shërbimet ligjore dhe sociale për viktimat e KO.

Punimi fillon me një analizë të rrjetit ligjor dhe strategjik në mënyrë që të përcaktohet mjedisi në të cilin veprojnë OShC-të. Për më tepër, janë analizuar burimet që OShC-të kanë në dispozicion duke bërë ndërlidhje me kapacitetet dhe njohuritë për t'u angazhuar në çështjet e KO. Për më tepër, punimi ofron shembuj të përpjekjeve aktuale dhe iniciativave të suksesshme nga sektori civil, duke demonstruar llojin e punës që është kryer në nivelin kombëtar deri më tani. Gjithashtu është analizuar bashkëpunimi i OShC-ve me institucionet e sistemit të drejtësisë penale, si dhe bashkëpunimi midis vetë OShC-ve. Perspektiva e institucioneve përshkruhet në një pjesë të veçantë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zbulimit të sfidave në mënyrë që të zhvillohen rekomandime praktike dhe të zbatueshme për përmirësimin e angazhimit civil kundër KO.

Analiza u krye përmes hulumtimeve në tryezë dhe në terren duke shqyrtuar dokumente ligjore dhe strategjike që rregullojnë punën e shoqërisë civile, raporte nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare dhe dokumente të tjera. Për më tepër, u zhvilluan pesë intervista duke përdorur një pyetësor në internet dhe dy intervista gjysmë të strukturuar fizike. Përveç kësaj, autori shqyrtoi pyetësorët në profilin e organizatave të zgjedhura që mbulojnë aspekte të ndryshme të KO dhe faqet e internetit të OShC-ve kur biseda me përfaqësuesit e tyre nuk ishte e mundur. Për më tepër, ka pasur një konsultë fizike me përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë penale.

| Analiza e kornizës ligjore dhe strategjike

Liria e asociimit për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat dhe bindjet politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera të qytetarëve garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.¹ Qytetarët mund të krijojnë lirisht shoqata qytetare, t'u bashkohen atyre ose të heqin dorë prej tyre. Kjo fushë është rregulluar më tej me Ligjin për Shoqata dhe Fondacione nga viti 2010.²

Sipas Regjistrat Qendror, kishte pothuajse 9,000 OShC të regjistruara në vitin 2018 (nga të cilat 8,780 ishin shoqata dhe 144 fondacione); pothuajse 6,000 prej tyre ishin aktive, me rreth 2,000 të punësuar.³

1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Neni 20

2 Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016.

3 Po aty.

Që nga viti 2004, Njësia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë ka qenë aktive. Qeveria gjithashtu ka një Strategji për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2018-2020) me një Plan Veprimi,⁴ si vazhdim të strategjive të mëparshme të ngjashme (2012-2017, 2007-2011), me tri qëllime strategjike: 1) korniza normative, institucionale dhe financiare për zhvillimin e shoqërisë civile; 2) demokratizimi, pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në politikëbërje dhe monitorim, veçanërisht në lidhje me procesin e integritimit në BE; dhe 3) shoqëria civile si akter në zhvillimin socio-ekonomik. Për më tepër ekziston Kodi i Praktikave të Mira për Pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile në Politikëbërje⁵ dhe Kodi i Praktikave të Mira për Mbështetje Financiare të OShC-ve.⁶

Në vitin 2018, Qeveria formoi Këshillin për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile si një organ këshillimor i Qeverisë i përbërë nga përfaqësues të OShC-ve dhe institucioneve shtetërore, duke mbuluar një gamë të gjerë çështjesh. Lufta kundër KO nuk përmendet qartë në asnjë nga dokumentet e Këshillit; megjithatë, mund të konsiderohet të jetë një çështje ndërsektoriale, e lidhur ngushtë me fushat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut, integritimin në BE, si dhe të rinisë dhe mbrojtjes sociale.

Në përgjithësi, mund të konkludohet se nuk ka pengesa zyrtare për OShC-të që të adresojnë KO. Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2020 vëren se “shoqëria civile mbetet aktive dhe luan rol kyç në proceset e politikës dhe vendimmarrjes”.⁷ Sidoqoftë, KE gjithashtu vuri në dukje se “nevojiten përpjekje për të siguruar një proces konsultimi më kuptimplotë dhe me kohë”.⁸

Studime të pavarura kanë vlerësuar mjedisin për zhvillimin e shoqërisë civile për vitin 2019 si “relativisht mundësues”, ku “liritë themelore të asociimit, mbledhjes dhe shprehjes ishin të garantuara ligjërisht, dhe përgjithësisht të mbrojtura dhe të gëzuara në praktikë”.⁹

Burimet

Në të kaluarën, lufta kundër KO konsiderohej si e drejtë sovraane e shtetit. Megjithatë, përgjatë viteve, OShC-të kanë treguar specializim, interes dhe rezultate në rritje në këtë fushë.

Shumica e OShC-ve që merren me çështjet e KO dhe korrupsionit në Maqedoninë e Veriut kanë marrë rolin e vëzhguesit, d.m.th., hulumtimin, monitorimin dhe avokimin për performancë më të mirë institucionale dhe rezultate në luftimin e KO. Korrupsioni në

4 Në dispozicion në: https://www.nvosorobotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/Akciski_plan2018-2020usvoen9102018.pdf

5 Gazeta Zyrtare Nr. 99/2011.

6 Gazeta Zyrtare Nr. 130/2007.

7 Komisioni Evropian, “Raporti i Maqedonisë së Veriut 2020”, Bruksel, tetor 2020. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf

8 Po aty.

9 Ognenovska, Simona. “Matrica e Monitorimit për Mundësimin e Mjedisit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Raporti për Maqedoninë e Veriut 2019, “Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Shkup, 2020.

lidhje me KO dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare janë pa diskutim temat e nxehta në mesin e OShC-ve maqedonase. Sidoqoftë, ka edhe organizata që merren me kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin e burimeve natyrore, krimet financiare, etj.

Shumica e OShC-ve kanë 1-5 punonjës që mbulojnë temat e KO pavarësisht nga madhësia e tyre, qofshin ato një organizatë më e vogël (me 1-5 punonjës) apo me madhësi të mesme (6-10 punonjës). Prandaj, shumica e organizatave mbulojnë një gamë më të gjerë të çështjeve, përfshirë luftën kundër KO dhe/ose korrupsionin. Sa i përket profilit të punonjësve, ata janë kryesisht hulumtues dhe juristë, por ka edhe gazetarë dhe njerëz që ofrojnë mbështetje sociale.

Duke pasur parasysh që temat e KO janë të lidhura ngushtë me profesionin ligjor, kjo është një nga fushat ku mund të vërehet një përfshirje më e madhe e akademisë, d.m.th., personelit të universitetit (profesorë dhe asistentë të profesorëve) në aktivitetet e shoqërisë civile. Shpesh, ata janë të përfshirë në ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitete arsimore për avokatët, prokurorët dhe profesionistë të tjerë.

OShC-të mund të marrin fonde nga burime të huaja dhe kombëtare publike dhe private, dhe ato gjithashtu mund të kryejnë veprimtari ekonomike për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Sidoqoftë, shumica e organizatave varen nga fondet e huaja, d.m.th., nga donatorët bilateral (ambasadat) dhe organizatat ndërkombëtare. Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia është përmendur si donatori i vetëm privat. Përveç kësaj, organizata të caktuara mbledhin pagesa të anëtarësimit; megjithatë, këto janë zakonisht shuma të vogla, më tepër simbolike.

Mungesa e fondeve në dispozicion për të adresuar KO ka kontribuar në mungesën e specializimit ose ndërmarrjen e një qasje strategjike në luftimin e KO. Disa bashkëbisedues theksuan rrezikun që menaxhmenti i OShC-ve ka të përshtatet me nevojat, pikëpamjet dhe qëndrimet e organizatave donatore, duke dëmtuar pavarësinë e vet. Për më tepër, çështjet financiare raportohen të ndikojnë në qarkullimin e personelit.

Çështja e qëndrueshmërisë financiare është e njohur nga qeveria dhe ka pasur përpjekje për të reformuar sistemin financiar shtetëror të shoqërisë civile. Disa OShC kanë kontribuar në adresimin e çështjes me monitorim, analizë dhe rekomandime.¹⁰ Sidoqoftë, ekzistojnë shqetësime të caktuara në lidhje me financimin shtetëror të aktiviteteve të monitorimit, veçanërisht ato që i referohen monitorimit dhe zbulimit të keqpërdorimeve të mundshme nga akterët shtetërorë. OShC-të duhet të jenë plotësisht të pavarura në hetimin dhe analizimin e rasteve të tilla, ku pavarësia financiare është thelbësore.

10 Ju lutemi shikoni: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar "Shoqëria e qëndrueshme civile - financimi shtetëror i OShC-ve" 2018-2021. <https://www.otcetnigo.mk/>. Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia siguroi një analizë dhe rekomandime (miratuar nga Qeveria më 24 nëntor 2020) brenda bashkëpunimit të saj të vendosur me Njësinë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Këshillin për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Në dispozicion në: <https://fosm.mk/current-project/prifateni-preporakite-koi-pridonesuvaat-vo-unapreduvan-je-na-okolinata-vo-koja-raboti-go/>.

